



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional në

“Shërbime Sociale dhe Komunitare”

ofruar nga

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Anisa Subashi

Dr. Migena Kapllanaj

Janar/ 2025

Tabela Përmbledhëse për Programin e studimit Master Profesional “Shërbime Sociale dhe Komunitare” ofruar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Sociologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 326, dt 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASR nr. 326, dt 17.09.2021
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA: Nr. 303 dt 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2020-2021: 9 PAE/0 PAK V.a 2021-2022: 9 PAE/0 PAK V.a 2022-2023: 9 PAE/0 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021: 17 studentë

		2021-2022: 14 studentë 2022-2023: 8 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare”, ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Universitetin Aleksandër Moisiu. Fillimisht i licensuar si program studimi Master profesional me 90 ECTS me shtrirje 1.5 vite akademike dhe në shtator 2021 është riorganizuar me urdhër të MAS në master profesional me 120 ECTS dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike. Programi është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor kombëtar dhe në përputhje me strategjinë e Institucionit ofrues, Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Misioni i programit të masterit “Shërbime Sociale dhe Komunitare” është të plotësojë nevojat e individëve që punojnë ose synojnë të punojnë në fushën e shërbimeve humane, sociale dhe komunitare si: shëndet mendor, edukim, ndihmë sociale dhe ndërmjetësim, si dhe shërbim publik. Programi synon të aftësojë studentët të zhvillojnë dijet e tyre profesionale, në fushën e shërbimeve komunitare. Mundësitë për punësim përfshijnë sektorin publik dhe privat, si ministritë, bashkitë, organizatat joqeveritare dhe ndërqeveritare, dhe agjencitë e huaja në vend.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm është hartuar në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e ASCAL për akreditimin të programit të Ciklit të Dytë të studimeve Master Profesional. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Anisa Subashi, Dr. Migena Kapllanaj është mbështetur nga Zj. Alma Arapi, koordinatorë teknike e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Puna për vlerësimin e jashtëm ka filluar me një takim të dy vlerësuesve me koordinatoren teknike të ASCAL, ku u diskutua mbi organizimin e punës. Raporti është përgatitur nga grupi i ekspertëve të vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i ngritur nga ASCAL. Hartimi i raportit kaloi përmes disa fazave. Fillimisht ekspertët u njohën me dokumentacionin dhe raportin e vlerësimit të brendshëm hartuar nga Grupi i vlerësimit të brendshëm për vlerësimin e programit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare”, në universitetin Aleksandër Moisiu. Ekspertët pas vlerësimit të dokumentacionit, evidencave të përgatitura nga Institucioni dhe leximit të kujdesshëm të raportit të vlerësimit të brendshëm u përgatitën për vizitën dy ditore në Institucion. Gjatë vizitës ekspertët realizuan disa takime me stafin mësimor, stafin administrativ, studentët e programit të studimit dhe realizuan vizita në mjediset ku ofrohet programi i studimit, në mjediset e punës së pedagogëve, në sekretarinë mësimore, bibliotekë dhe mjedis të tjera në funksion të programit të studimit dhe studentëve. Pas vizitës, ekspertët përgatitën listën e evidencave plotësuese të cilat u dorëzuan përmes sistemit të ASCAL në kohë nga

institucioni. Më pas ekspertët përgatitën këtë draft raport, ku janë përmbledhur edhe pikat e forta pikat e dobëta dhe rekomandimet për përmirësim.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.01.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1 / 2 Prot, datë 07.01.2025. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës njofton në ASCAL ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master profesional në “Shërbime sociale dhe komunitare” nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ndikon në ruajtjen e konsolidimin e interesave akademike e kulturore kombëtare. <i>(EV. Statuti i IAL, Plani strategjik)</i> Programi i studimit Master Profesional “Shërbime Sociale dhe Komunitare” ndjek dhe reflekton këto interesa kombëtare, gjë e cila shprehet në misionin dhe qëllimin e tij <i>(EV. Rregullore e programit të studimit)</i> . Ky program synon përgatitjen e specialisteve në fushën e Shërbimeve Sociale dhe Komunitare, të aftë në përmbushjen e marrëdhënieve publike në institucionet publike e private në përputhje me prioritetet e vendit. Programi synon të formojë specialistë në fushën e përkujdesit social, duke iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe perspektive të tregut të punës.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit "Shërbime Sociale dhe Komunitare" është strukturuar në përputhje me kuadrin ligjor, udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), si dhe objektivat strategjike të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD). Objektivat e këtij programi, të përfshirë në rregulloren përkatëse, janë në harmoni me standardet akademike për programet Master Profesional <i>EV. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Plani i Zhvillimit Strategjik në Fakultetin e Edukimit; Plani i Zhvillimit Strategjik i Departamentit të Sociologjisë)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e	Programi i studimit Master profesional në “Shërbime sociale dhe komunitare” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit, rregulloren e tij dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. Programi i studimit është në përputhje me kuadrin ligjor përcaktues në fuqi. Përkatësisht ai mbështetet në Statutin e UAMD, (Neni 8, pika 2; Neni 80), Rregulloren e UAMD, (Neni 10, pika 2; Neni 41, pika 3), Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, (Neni 43), Rregulloren e Departamentit të Sociologjisë, (Neni 1), Rregulloren e Programit të Ciklit të dytë të studimeve

drejtimet akademike së Institucionit.	Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare", (Neni 1, Neni 4).			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>Programi i studimit Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare" zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare intersin kombëtar por edhe me prirjet globale kryesisht lidhur me sinergjinë mes shkencave të ndryshme.</p> <p>Pavarësisht dëshirës së mirë për të krijuar një program që aftëson studentët në fushën e sociologjisë por edhe të shërbimeve komunitare, ka ende nevojë për të vlerësuar nëse studentët fitojnë kompetencat e nevojshme si në fushën e sociologjisë edhe në fushën e gjerë të shërbimeve sociale. Nga analiza e programit të studimit, rregullores së programit, sylabuseve të lëndëve dhe planit mësimor del në pah nevoja për të krijuar një sinergji më të mirë mes njohurive në fushën e sociologjisë në njërën anë dhe aftësive praktike të studentëve në fushën e shërbimeve sociale dhe për të krijuar një sinergji më të mirë në zhvillimin e profesionistëve me kompetencat dhe njohuritë e nevojshme për tregun e punës.</p> <p>(Ev. 24, 24.1, 9)</p>			
Konkluzione	<p>Programi i studimit është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e UAMD, duke respektuar dhe ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare. Programi i studimit Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" është ndërtuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD), dhe synon përgatitjen e specialistëve të aftë për përmbushjen e nevojave të tregut të punës në fushën e shërbimeve sociale dhe komunitare. Programi reflekton interesat kombëtare dhe përputhet me strategjitë kombëtare dhe globale të zhvillimit, duke respektuar kuadrin ligjor dhe rregullator të institucionit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike	<p>Institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programit të studimit.</p> <p>Referuar kualifikimeve të stafit akademik 8 nga 9 janë të fushës së sociologjisë dhe filozofisë, vetëm një staf me kohë të plotë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>është kualifikuar në fushën e punës sociale. Nisur nga përmbajtja e programit, njësia bazë duhet të angazhojë staf në fushën e punës sociale në mësimdhënie në lëndët që lidhen me fushën e shërbimeve sociale.</p> <p><i>(EV. Plani i Zhvillimit Strategjik në Fakultetin e Edukimit; Plani i Zhvillimit Strategjik i Departamentit të Sociologjisë; Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Departamentin e Sociologjisë.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi master profesional në “Shërbime sociale dhe komunitare” ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti i Edukimit.</p> <p>Programi i studimit është i orientuar kryesisht në fushën e shërbimeve sociale. Në planin strategjik për programin e studimit dhe në rregulloren e tij misioni i programit të studimit përshkruhet: “Misioni i programit të masterit është të plotësojë nevojat e individëve që punojnë ose synojnë të punojnë në fushën e shërbimeve humane, sociale dhe komunitare si: shëndet mendor, edukim, ndihmë sociale dhe ndërmjetësim, shërbim publik. Aftësitë e përfituara do t’u mundësojnë studentëve të të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, për t’u ardhur në ndihmë tregut të punës dhe të shërbejnë në komunitet dhe shoqëri.” Si edhe duket nga misioni i programit por edhe nga përmbajtja e tij në planin mësimor dhe syllabuse programi është kryesisht në fushën e shërbimeve sociale.</p> <p><i>(EV. Plani strategjik i programit të studimit, Rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional “Shërbime Sociale dhe Komunitare” nuk është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Ndërkohë që emërtimi dhe përmbajtja e programit është në fushën e shërbimeve sociale, njësia bazë është departamenti i sociologjisë. Fusha e sociologjisë dhe fusha e shërbimeve sociale i përkasin dy grupimeve të ndryshme sipas udhëzimeve për kodifikimin e programeve në fuqi.</p>

<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>NA</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni ka sruktura të ndryshme që ofrojnë mundësi për trajnime profesionale si Zyra e Alumnit dhe Karrierës dhe Qendra për edukim në vazhdim. Universiteti ka gjithashtu një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh kryesisht universitete dhe institute e qendra studimore dhe ka evidenca për angazhimin e studentëve në konferenca, projekte studimore. (Ev. <i>Dosje e riorganizimit të programit të studimit, Studentët e trajnuar nga Zyra e Karrierës; Forume, Seminare dhe Workshop-e akademike të organizuara në UAMD, 2018-2021</i>; studentët e Mp SHSK të përfshirë në projekte). Departamenti i sociologjisë ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile në funksion të programit të studimit. (Ev. 2 lista e dokumenteve shtesë)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni arsimor ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programit të studimit në “Shërbime Sociale dhe Komunitare”. Institucioni ka struktura që ofrojnë trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit, si Zyra e Alumnit dhe Karrierës dhe Qendra për Edukim në Vazhdim. Gjithashtu, departamenti i sociologjisë ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile për funksion të programit të studimit, duke ofruar mundësi për përfshirjen e studentëve në konferenca, projekte studimore dhe aktivitete të tjera profesionale.</p> <p>Për të përmirësuar më tej cilësinë e programit të studimit, ekspertët rekomandojmë që të punësohen pedagogë në fushën e shërbimeve sociale e punës sociale, duke qënë se aktualisht është stafi është i fushës së sociologjisë dhe filozofisë. Gjithashtu departamenti duhet të konsiderojë mundësinë për riorganizimin e programit në një fushë më specifike të shërbimeve sociale ose në fushën e sociologjisë për ta përshtatur edhe me fushën e specializimit të njësisë bazë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	---	--

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucioni ka akte rregullatorë të brendshme për hartimin mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit (<i>EV. Rregullore e Universitetit, rregullore e fakultetit, Rregullore e departamentit, Rregullore e programit të studimit, rregullore e NJSBC</i>).</p> <p>Departamenti i Sociologjisë në funksion të mbarëvajtjes së punës në drejtim të zbatimit të programit mësimor në Master profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi brenda fakultetit me departamente të tjera për të mundësuar realizimin efektiv të objektivave që ka ky program studimi. Realizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit ka qënë i nevojshëm për mbulimin e lëndëve e moduleve që përbëjnë kurrikulën e këtij programi studimi dhe që zhvillohen nga lektorë jashtë departamentit.</p> <p><i>(Ev. Lista e stafit mësimor mësimdhënës në program)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit si njësi kryesore e UAMD, për realizimin e objektivave të programit të studimit, si dhe procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p> <p><i>(EV. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD; Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Edukimit, Erasmus – Inter-Institutional Agreement 2014-2021 and 2015-2021 for mobility)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për</p>	<p>Për zbatimin e programit të studimit Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare," universiteti, fakulteti dhe departamenti kanë krijuar partneritete institucionale në nivel lokal dhe kombëtar, duke nënshkruar marrëveshje me organizata publike dhe kompani private. Këto bashkëpunime synojnë të sigurojnë mundësi për aftësim praktik profesional të studentëve, duke i angazhuar ata në aktivitete konkrete pranë institucioneve dhe kompanive partnere.</p>

<p>realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj,dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>(Ev. Lista e marrveshjeve të bashkëpunimit të fakultetit dhe Lista e bashkëpunimit të Departamentit)</p> <p>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Sociologjisë kanë krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me bashki, njësi administrative dhe aktorë të sektorit privat në fushën e Shërbimeve Sociale dhe Komunitare. Ky bashkëpunim synon të mbështesë realizimin e programit të studimit, duke garantuar kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale të studentëve. Përmes kësaj qasjeje, studentët përfitojnë aftësim praktik dhe përfshirje të drejtpërdrejtë në proceset dhe funksionet e Shërbimeve Sociale dhe Komunitare. Ev. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Sociologjisë; Ev. Analizë Vjetore e Departamentit të Sociologjisë 2020-2022.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti, në analizën vjetore të punës, ka evidentuar përfitimet që rrjedhin nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të realizimit të programit të studimit. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve janë realizuar shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ, si dhe të studentëve. Për më tepër, janë organizuar aktivitete informuese dhe leksione të përbashkëta, duke kontribuar në pasurimin e përvojës akademike dhe praktike për të gjithë palët e përfshira. (Ev. Analizë Vjetore e Departamentit të Sociologjisë 2020-2022)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar një rrjet të fortë marrëdhëniesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, për të siguruar mbështetje në realizimin e programit të studimit, aftësimin profesional, kërkimin shkencor dhe mobilitetin e stafit dhe studentëve. Këto bashkëpunime kanë qenë të rëndësishme për mbulimin e lëndëve dhe moduleve të ndryshme, realizimin e praktikave profesionale dhe shkëmbimin e përvojave akademike dhe administrative.</p> <p>Për të përmirësuar më tej këto marrëdhënie bashkëpunimi, institucioni duhet të zhvillojë mekanizma më të strukturuar për monitorimin dhe vlerësimin periodik të përfitimeve që rrjedhin nga këto marrëveshje bashkëpunimi, duke përfshirë analiza të detajuara dhe raporte të rregullta si dhe të rrisë angazhimin e studentëve dhe stafit në aktivitete të përbashkëta</p>

	ndërkombëtare dhe mobilitetin akademik, për të zgjeruar horizontet e tyre profesionale dhe akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” është i strukturuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module, pesha e të cilave vlerësohet me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Mbështetur në VKM, Nr.41, (datë 24.1.2018), Statutin e UAMD, dhe në urdherin e MAS Nr. 326, datë.17.09.2021 për riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” është i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse, duke respektuar legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS).</p> <p><i>(Ev. Plani mësimor i programit të studimit)</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri	Programi i studimit ofron mundësinë për formimin e shprehive të veçanta dhe të larmishme në fushën e sociologjisë, shërbimeve sociale dhe edukimit. Programi është i organizuar në mënyrë të tillë që t’ju ofrojë studentëve formim të përgjithshëm në drejtime të ndryshme në fushën e shërbimeve sociale. Lëndët karakterizuese të

<p>të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>programit nuk thellohen në një fushë studimi apo punësimi por japin njohuri të përgjithshme në fusha të ndryshme të shërbimeve sociale si psh Probleme sociale dhe të shëndetit mendor, Shërbimet komunitare, minoritetet dhe pakicat, Legjislacioni dhe politika sociale te avancuara, Administrimi i projekteve sociale dhe komunitare, Komuniteti dhe shërbimet vullnetare, Ndryshimi social, lidershipi dhe advokacia, Studime mbi familjen dhe martesën dhe Komunikimi dhe media sociale. (EV. Plani mësimor, Rregullore e studimeve). Referuar përmbajtjes së syllabuseve, rezultateve të të nxënit dhe koncepteve themelore shumë prej lëndëve janë të karakterit teorik më shumë se praktik, gjë që do ta pasuronte aftësimin profesional praktik të studentëve në një fushë të caktuar të shërbimeve sociale.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” ka të përcaktuara ngarkesën mësimore në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse sipas udhëzimit në fuqi (EV. Plani mësimor, syllabuset e lëndëve). Pesha e krediteve dhe numri i orëve për kredit është në përputhje me VKM Nr. 879 dt. 18.12.2019. Në planin mësimor janë ndarë qartë kreditet dhe ngarkesa për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Plani mësimor është i detajuar sipas Veprimtarive Formuese të tipit A, B, C, D, dhe E sipas VKM Nr. 879 dt. 18.12.2019. Ndarja e lëndëve dhe moduleve në planin mësimor i përgjigjet plotësisht këtyre kategorive të përcaktuara. Në planin mësimor të këtij program studimi përcaktohen lëndët/modulet e programit të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese:</p> <p>A – Lëndë Bazë, 10% me 12 ECTS me 2 lëndë B – Lëndë Karakterizuese, 40% me 48 ECTS me 8 lëndë C – Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese 10% me 24 ECTS me 2 lëndë D – Lëndë Plotësuese 10% me 12 ECTS me 1 lëndë E – Lëndë Detyrime Përmbyllëse 20% me 24 ECTS me 1 lëndë</p> <p>Pesha e krediteve përcaktuar për praktikën profesionale përputhet plotësisht me VKM, por ka një gabim në llogaritje me numrin total të orëve për praktikë profesionale dhe detyrime përmbyllëse. Totali i orëve nuk i korrespondon numrit të krediteve. Gjithashtu nuk</p>

	<p>është bërë shpërndarja e orëve sipas veprimtarive mësimore. Numri i orëve të praktikës profesionale është shumë i ulët, vetëm 75 orë në auditor. Ka nevojë për një rikonceptim të orëve të shpenzuara në praktikë profesionale duke ulur orët në auditor (sipas edhe sylabusit) dhe duke rritur orët e praktikës në institucion. Referuar tipologjisë rritja e numrit të orëve të praktikës jo vetëm si lëndë por edhe në lëndët e tjera karakterizuese është shumë e rëndësishme për aftësimin profesional të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	NA
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	NA
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e</p>	NA

<p>arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>NA Masteri Profesional “Shërbime Sociale dhe Komunitare” ofrohet vetëm nga DS, Fakulteti i Edukimit, UAMD.</p>
<p>Kriteri 8.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e Europiane.</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nuk është program i përbashkët</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” është strukturuar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi përmban elemente të qarta strukturore të vlerësuara në kredite, përfshirë lëndët bazë të detyrueshme, lëndët karakterizuese, lëndët ndërdisiplinore dhe</p>

	<p>detyrimet përmbyllëse, duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Në përmbyllje të vlerësimit për këtë standard ekspertët rekomandojnë të shtohet komponenti praktik në lëndët e programit, duke reduktuar përmbajtjen teorike dhe duke integruar më shumë ushtrime praktike dhe punë në terren; të rishikojë dhe të rikonceptojë shpërndarjen e orëve të praktikës profesionale, duke ulur orët në auditor dhe duke rritur orët e praktikës në institucione të lidhura me fushën e shërbimeve sociale për të rritur aftësimin praktik të studentëve; të korrigojë gabimi në llogaritjen e numrit total të orëve për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Për ti dhënë më shumë peshë praktikës profesionale rekomandojmë gjithashtu që përveç lëndës së praktikës profesionale, duhet të integrohen më shumë orë praktike në lëndët karakterizuese për të rritur formimin profesional të studentëve në fusha specifike të shërbimeve sociale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Edukimit si njësi kryesore dhe Departamenti i Sociologjisë si njësi bazë, i përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike dhe vlerësimin e akreditimit. Stafi Akademik i Departamentit të Sociologjisë për vitin 2022-2023 është i përbërë nga 9 anëtarë, ku 1 anëtar është me titullin Prof. Dr, 2 anëtarë me titullin Prof. Asoc. Dr, dhe 6 anëtarë janë me Gradën Shkencore “Doktor Shkencash”. (EV. Të dhëna tabelore për stafin akademik, Statuti I UAMD)</p> <p>Fakulteti i Edukimit, si njësi kryesore, dhe Departamenti i Sociologjisë, si njësi bazë, disponojnë një strukturim organizativ në çdo shkallë të</p>

hierarkisë duke iu përshtatur nevojave të programit të studimit. Organizimi dhe struktura akademike detajohen në Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Rregulloren e Departamentit të Sociologjisë. Stafi është kryesisht nga fusha e sociologjisë dhe filozofisë, me mungesë të specialistëve në shërbime sociale dhe punë sociale

Departamenti i Edukimit për tre vite akademike ka në përbërjen e tij:

Departamenti i Edukimit	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1		1		1	
Prof.As.Dr	1		1		1	
Dr	7		7		7	
MSc	1		1			
Total	10	0	10	0	9	0

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës

UAMD ka një rrjet të gjerë strukturash mbështetëse në funksion të studentëve dhe procesit mësimor të tilla si dega e zhvillimit të kurrikulave, zyra e alumnit, zyra mësimore dhe të tjera struktura mbështetëse. Stafi i angazhuar në procesin mësimor përfshin pedagogë me kohe të plotë dhe të pjesshme. *Stafi është kryesisht nga fusha e sociologjisë dhe filozofisë, me mungesë të specialistëve në shërbime sociale dhe punë sociale*

(EV. Lista e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit)

akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.									
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Departamenti i Sociologjisë cakton një koordinator për programin e studimit që është përgjegjës për përgatitjen e paketës, koordinimin e përgatitjes së materialeve pedagogjike, të praktikave profesionale dhe udhëzimeve për temën e diplomimit, duke siguruar dhe mbikqyrjen e tyre, Kjo detyrë, është e specifikuar gjithashtu, edhe në Rregulloren e Departamentit të Sociologjisë, neni 3 dhe neni 9 si dhe në rregulloren e programit të studimit neni 11, neni 31.</p> <p><i>(EV. Rregullore e studimit, Rregullore e departamentit)</i></p>								
Konkluzione	<i>Stafi është kryesisht nga fusha e sociologjisë dhe filozofisë, me mungesë të specialistëve në shërbime sociale dhe punë sociale</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Departamenti i Sociologjisë në Fakultetin e Edukimit në UAMD, është njësia bazë mësimore-kërkimore, që disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare”</p> <p><i>(EV. Rregullore e departamentit, rregullore e programit të studimit, plani mësimor, syllabuset e lëndëve)</i></p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” përmban planin mësimor ku përfshihen të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën mësimore, dhe orët jashtë auditorit dhe mënyrën e vlerësimit. Plani mësimor është i hartuar me të gjithë përbërësit sipas kuadrit ligjor në fuqi me lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse. Programi ka në total 120 ECTS dhe 1500 orë mësimi në auditor dhe studim individual. Shpërndarja e orëve për kredit është sipas udhëzimeve në fuqi.</p> <p><i>(Ev. Plani mësimor i ri dhe i riorganizuar)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit ofrohen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit dhe dokumentacionin e pranimit. Nuk ka specifikim rreth kriterëve të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit. Në rregulloren e programit nuk ka parashikime lidhur me transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Kriteret lidhur me transferimin janë të parashikuara në rregulloren e Fakultetit, por jo në rregulloren për ekuivalentimin</p> <p><i>(Ev. Rregullore e programit të studimit).</i> <i>(Ev. Rregullore e Fakultetit, Rregullore e Universitetit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Dosja e plotë e programit të studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” përmban informacione të nevojshme lidhur me syllabuset për secilën lëndë përfshirë praktikën, orët e seminareve dhe leksioneve. Syllabuset janë në përputhje me formatet e miratuara. Në disa prej syllabuseve ka nevojë për më shumë qartësi për mënyrën e organizimit të orëve të seminareve.</p> <p><i>(EV. Rregullore diplomimi FE)</i> <i>(Ev. Plani mësimor).</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti</p>	<p>Programi i studimit ka kaluar në proces riorganizimi dhe është rishikuar tërësisht në përmbajtje duke demonstruar karakterin dinamik të programit të studimit. Gjatë takimeve me stafin akademik u konstatua procedura e përditësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Megjithatë nga analiza e syllabuseve të</p>

<p>akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>lëndëve duket se ka shumë për të përmirësuar veçanërisht lidhur me literaturën e përdorur në programet mësimore. Në pjesën dërrmuese të syllabuseve literatura është e vjetër (më e vjetër se e 5 viteve të fundit) dhe nuk reflekton ndryshimet e fundit që ndodhin në fushën e shërbimeve sociale brenda dhe jashtë vendit. Literatura duhet të pasurohet me literaturë të përditësuar, artikuj shkencorë në fushën e shërbimeve sociale.</p> <p><i>(EV. Plani mësimor, rregullore e departamentit, syllabuset e lëndëve)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" shfaq pika të forta në organizim dhe strukturë. Departamenti i Sociologjisë në Fakultetin e Edukimit në UAMD është njësi bazë mësimore-kërkimore përgjegjëse për programin e studimit dhe disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e tij. Planifikimi mësimor është i detajuar dhe përfshin informacion të plotë rreth ngarkesës mësimore dhe orëve mësimore jashtë auditorit. Gjithashtu, programi përmban të gjitha informacionet e nevojshme për programet lëndore, duke përfshirë syllabuset për praktikant, seminarët dhe orët e laboratorit. Megjithatë, për të përmirësuar programin, rekomandohet një përditësim dhe përmirësim i vazhdueshëm i përmbajtjes së programit, duke siguruar që literatura e përdorur të jetë e përditësuar dhe e pasuruar me artikuj shkencorë të fundit në fushën e shërbimeve sociale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe</p>	<p>Programi Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" është një program që synon kualifikimin e studentëve në fushën e shërbimeve sociale. Përmbajtja e programit është e natyrës gjeneraliste duke ofruar informacion të përgjithshëm për çështje të ndryshme sociale, por</p>




<p>aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>nuk krijon mundësinë për tu thelluar në një nga fushat e problemeve sociale. Lëndët karakterizuese të programit përfshijnë trajtimin e problemeve sociale dhe të shëndetit mendor, shërbimet komunitare, minoritetet e pakicat, projektet sociale komunitare, studime mbi familjen dhe martesën. Përmbajtja e syllabusese është kryesisht e natyrës teorike dhe jo teknike praktike. Duke ofruar sërish njohuri teorike të përgjithshme në fusha të ndryshme të shërbimeve sociale si dhe duke plotësuar formimin e studentëve me lëndë të shkencave sociale jo të lidhur a drejtëpërdrejtë me shërbimet sociale në komunitet si psh studime mbi familjen dhe martesën, ndryshimi social lidhshipi dhe avokacia, komunikimi dhe media sociale, profili profesional i të diplomuarve është i paqartë. Është e nevojshme që programi të ketë një profilizim duke qenë se është program i ciklit të dytë dhe thellimi i njohurive në një nga fushat dhe aftësimi teknik e praktik janë të rëndësishme për integrimin e të diplomuarve në tregun e punës.</p> <p><i>(EV. Dosje Ri-Organizimi MP Shërbime Sociale dhe Komunitare Viti 2021, Dosja e programit të studimit: Kurrikula, Struktura mësimore, Plani mësimor, Syllabuset).</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” ka shpërndarje të lëndëve në vite e semestra në mënyrë të qartë. shpërndarja e peshës së krediteve për secilën lëndë është e njëjtë. çdo lëndë ka 6 kredite dhe 45 orë në auditor nga të cilat 30 leksione dhe 15 seminare dhe 105 orë për studim individual. Kjo shpërndarje uniformë nuk lejon thellimin e njohurive në fusha që kërkojnë vëmendje më të madhe. Një shembull do të ishte që lëndët që janë të lidhura drejtë përdrejtë me shërbimet sociale në komunitet mund të kenë një peshë më të madhe dhe rubrikat e veprimtarive mund të diversifikohen duke shtuar orë për praktikë pasive apo aktive në kuadër të lëndës. shtimi i orëve praktike sipas lëndëve do e pasuronte eksperiencën dhe ekspertizën e studentëve. Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me disa qendra që ofrojnë shërbime sociale dhe studentët mund të shpenzojnë më shumë orë praktike edhe në kuadrin e lëndëve specifike duke përfituar edhe më shumë nga përvoja në praktikë. Praktika në kuadër të lëndës do të përmirësonte edhe periudhën kur shtrihet praktika profesionale duke u aftësuar hap pas hapi.</p> <p>Lidhur me lëndën e praktikës profesionale Departamenti ka një syllabus për praktikën profesionale. Për 12 kredite janë parashikuar të gjitha orët, 300 në praktikë, ndërkohë që ka nevojë për një numër</p>

	<p>të vogël orësh për studim individual. psh rreth 10-15 orë për përgatijen e raportit të vlerësimit. në syllabusin e praktikës detajohen tema, por gjykoj që më me vlerë do të ishte një dokument udhëzues për praktikën profesionale në formën e një pakete ku të përshkruhet procesi, orët e shpenzuara në institucion, roli i institucionit pritës dhe supervizorit të praktikës në institucion, pedagogut mbikqyrës i praktikës profesionale, format e vlerësimit dhe instrumente mbështetës, modeli i raportit të praktikës etj. Gjykojmë gjithashtu që është e rëndësishme të ketë një marrveshje individuale të praktikës profesionale ku të përshkruhet edhe plani i dakordësuar i praktikës profesionale.</p> <p><i>(EV. Syllabuset e lëndëve, dosja e praktikës, rregullore e praktikës.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Shërbime sociale komunitare” qëndron mes fushës së sociologjisë dhe fushës së punës sociale dhe gjykojmë që ka nevojë të rishikojë profilin e profesionistëve që synon të zhvillojë. Përbërja e planit mësimor dhe përmbajtja e programeve në disa raste mbetet në nivelin analitik dhe teorik dhe ndërkohë në disa të tjera në planin praktik. Gjykojmë që programi ka nevojë për tu riorganizuar tërësisht në planin teorik në fushën e sociologjisë, ku studentët të aftësohen si njohës dhe stujdues në fushën e shërbimeve sociale e komunitare. Në këtë rast do të ishte e nevojshme të rishikohej përmbajtja e syllabuseve lidhur me vlerësimin e problemeve sociale dhe shoqërore e komunitare. Kjo do e përputhte më së miri programin edhe me njësinë bazë që e ofron këtë program dhe kualifikimet e stafit mësimor. Në rast riorganizimi në fushën e shërbimeve sociale, programi ka nevojë të rishikojë përbërjen e lëndëve duke shtuar lëndë të zhvillimit njerëzor dhe komunitar, lëndë të shërbimeve sociale kryesore, mënyrës së organizimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale, teknika të ofrimit të shërbimeve dhe aftësim praktik për ofrimin e shërbimeve sociale. ndërkohë programet në fushën e shërbimeve sociale kanë nevojë për më shumë orë praktike të cilat mund të organizohen edhe në nivel lëndë apo moduli. Përmbajtja aktuale e programit të studimit nuk garanton formim, aftësi dhe kompetenca të thelluara në fushën e shërbimeve sociale.</p> <p><i>(EV. Plani mësimor, Syllabuset e lëndëve, Rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" ka ndarje të veprimtarive formuese në përputhje me</p>

<p>dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>udhëzimet në fuqi. Shpërndarja e uniformizuar e krediteve orëve mësimore leksione seminare gjithashtu mund të rishikohet ndërmjet lëndëve dhe në nivel lëndë në përputhje me me objektivat e secilës lëndë duke diferencuar rëndësinë që ka secila në formimin teorik e praktik të studentëve. Mund të shohet edhe orë të formimit praktik në nivel lëndë për të pasuruar më tej aftësimin praktik profesional. Për shkak të natyrës gjeneraliste të programit transferimi i studimeve bëhet i vështirë në programet e tjera të punës sociale në vend.</p> <p><i>(EV. Plani mësimor, Syllabuset e lëndëve, Rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përditësohen periodikisht dhe pasurohen me literaturë bashkëkohore. Do të ishte me vlerë që përditësimet në syllabuse të bëheshin edhe pas konsultimeve periodike me organizatat bashkëpunuese për të përmirësuar jo vetëm literaturën por edhe temat dhe çështjet dhe problematikat e trajtuara.</p> <p><i>(EV. Plani mësimor, Syllabuset e lëndëve, Rregullore e programit të studimit, lista e marrveshjeve të bashkëpunimit për programin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i pajis studentët me njohuri në disa drejtime në fushën e shërbimeve sociale dhe zhvillimit shoqëror. Ai ka në përmbajtjen e tij lëndë dhe module specifike të veprimtarive formuese, ku dominojnë disiplinat e formimit karakterizues, por edhe disiplina të formimit bazë të përgjithshëm.</p> <p><i>(EV. Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" u mundëson studentëve formimin e tyre profesional, me informacion të gjërë në fushën e shërbimeve sociale. Nga studimi i tregut të punës <i>(EV. Studim i tregut të punës për studentët e diplomuar)</i> rezulton se studentët janë të punësuar në sektorin e shërbimeve sociale.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" ka disa pika të forta që e dallojnë, duke përfshirë një program të orientuar drejt kualifikimit të studentëve në fushën e shërbimeve sociale dhe komunitare, si dhe një shpërndarje të qartë</p>

	<p>të lëndëve në vite dhe semestra, që siguron një peshë të barabartë të kredive për secilën lëndë. Gjithashtu, përditësimi i syllabuseve të lëndëve në mënyrë të vazhdueshme siguron që studentët marrin kompetenca dhe njohuri të përditësuara në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Megjithatë, për të përmirësuar programin, ka nevojë për disa rekomandime kyçe, duke përfshirë nevojën për një profilizim të qartë dhe thellim të njohurive në njërin nga fushat e shërbimeve sociale, rishikimin e shpërndarjes së krediteve dhe orëve mësimore për të siguruar një diferencim të rëndësishëm të secilës lëndë për formimin teorik dhe praktik të studentëve, si dhe përmirësimin e profilizimit dhe thellimit të njohurive për të garantuar përfundimin e dijeve dhe aftësive të synuara për fushën e shërbimeve sociale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti ka zhvilluar studim tregu për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe programi është riorganizuar. Departamenti dhe fakulteti ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh brenda dhe jashtë vendit gjë që mundëson dhe krijon kushtet për konsultime periodike. Megjithatë nuk ka procese periodike të përmirësimit të kurrikulës që do të garantonin edhe modalitetet e përfshirjes dhe konsultimit me palët e interesuara.</p> <p><i>(Dosja e riorganizimit të programit, Studimi i tregut, Lista e marrveshjeve)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe</p>	<p>Institucioni mbledh periodikisht mendimin e studentëve lidhur me ofrimin e programit të studimit <i>(EV. Anketimi i studentëve, Formulari i vlerësimit për programin nga studentët)</i>. Studentët janë</p>

<p>strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>të angazhuar edhe në veprimtarinë akademike sociale e kërkimore të Universitetit gjë që lehtëson komunikimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e procesit mësimor. <i>(EV. Programi i konferencës, Aktivitete të zyrës së karrierës dhe Alumnit, Raporti vjetor i departamentit)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Sociologjisë kanë një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh si në fushën akademike e kërkimore edhe në fushën e shërbimeve sociale në funksion të programit të studimit. Programi ka kaluar në proces riorganizimi dhe është bërë një proces konsultimi me të dhëna në fushë por edhe intervista me studentë dhe punëdhënës. Gjykojmë që do të ishte me rëndësi që konsultimi për ofrimin e programit të studimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tij të strukturohej në procese periodike konsultimi me studentë dhe organizata të shoqërisë civile për të rritur edhe më shumë komunikimin dhe ndërveprimin me ta.</p> <p><i>(EV. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe të programit të studimit)</i> <i>(EV. Studimi i tregut)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Departamenti dhe Fakulteti kanë zhvilluar studime tregu dhe kanë një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh brenda dhe jashtë vendit. Konsultimet me studentët dhe strukturat e tyre kryhen periodikisht, dhe studentët janë të angazhuar në veprimtari akademike, sociale dhe kërkimore të universitetit.</p> <p>Ekspertët rekomandojnë që proceset periodike të përmirësimit të kurrikulës dhe strukturimi i konsultimeve me palët e interesuara janë të pamjaftueshme. Konsultimet me të diplomuarit, institucione partnere dhe aktorët e tjerë nga tregu i punës kryhen, por nuk janë të strukturuar në mënyrë sistematike dhe të rregullt. Institucioni ka mundësinë të përmirësojë më tej përmbajtjen e programit të studimit duke formalizuar dhe intensifikuar këto konsultime dhe përditësime.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi Master Profesional “Shërbime Sociale dhe Komunitare” ka si objektiv kryesor ofrimin e një formimi të balancuar teorik dhe praktik për studentët. Objektivat e programit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Brendshme të Departamentit dhe detajohen në syllabuset e lëndëve dhe moduleve që përbëjnë këtë program studimi, duke siguruar një strukturë të mirëorganizuar dhe të orientuar drejt përgatitjes profesionale të studentëve. Objektivat janë në harmoni edhe me objektivat madhorë të institucionit specifikuar në strategjinë e tij. <i>(EV. Rregullore e programit të studimit, Strategjia e IAL)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Sociologjisë përmbush kriteret e nxitjes, bashkërendimit dhe administrimit të veprimtarive mësimore dhe kërkimore, duke respektuar lirinë akademike. Departamenti zgjedh me kujdes personelin akademik të kualifikuar dhe përmbush të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Personeli akademik, si me kohë të plotë ashtu edhe me kohë të pjesshme, ka kualifikimet e duhura për të realizuar objektivat e programit, duke siguruar një standard të lartë të mësimdhënies dhe kërkimit. <i>(EV lista e stafit akademik (EV.Kodii etikës, Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore të zhvilluara në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Departamenti i Sociologjisë përmbush kriterin e nxitjes dhe motivimit të studentëve për të angazhuar në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Departamenti përdor mekanizma dhe procese formale për të shqyrtuar, miratuar dhe mbikëqyrur programin e studimit, duke ofruar mundësi të shumta për studentët që të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në projekte dhe konferenca studentore, ku mund të diskutojnë problematikat dhe të kërkojnë zgjidhje konkrete. Për më tepër, disa studentë kanë përfituar nga projekte si Erasmus+, duke realizuar studime dhe kërkime shkencore të lidhura me temat e diplomës së tyre. <i>(EV. Të dhënat për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor për anëtarët e departamentit në 5 vitet e fundit; Vendim për grupet e punës në Konferencën e FE 2020/2022, aktivitete konferencash studentore. Programi I konferencës; Temat e diplomave)</i>

<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Institucioni mbështet financiarisht njësinë bazë dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme, duke i ofruar studentëve mundësinë të prezantojnë në konferenca studentore dhe të marrin pjesë në workshope të ndryshme. Departamenti garanton pjesëmarrjen aktive të studentëve në diskutime të hapura, duke përmirësuar aspektet praktike të formimit të tyre teorik.</p> <p>Për më tepër, financimi nga fondet e Universitetit për kërkimin shkencor mbulon projekte të hartuara nga stafi akademik. Këto fonde mbështesin gjithashtu organizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si konferenca dhe workshope, si dhe botimin e artikujve shkencorë në revista ndërkombëtare të indeksuara nga Scopus dhe Journal Citation Report. Stafi akademik i UAMD gjithashtu përfiton nga financimi për pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare, duke lehtësuar tarifat e pjesëmarrjes kur ka fonde të disponueshme.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë përmbush kriteret për orientimin në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Programi Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" ka objektiva të qarta dhe të mirëpërcaktuara, që janë në harmoni me objektivat madhorë të institucionit. Departamenti nxit dhe administron veprimtaritë mësimore dhe kërkimore, duke respektuar lirinë akademike në përpjekje për të ruajtur standard të lartë të mësimdhënies. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në projekte dhe aktivitete kërkimore, ndërsa financimi nga institucionet mbështet këto aktivitete.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të</p>	<p>Personeli akademik në Departamentin e Sociologjisë angazhohet në përpjekje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre. Cilësia e procesit mësimor vlerësohet vazhdimisht nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, e cila bën rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e kërkuar. Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

27

<p>programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>kryesisht në formën e sondazheve me studentët. Departamenti angazhon personel akademik dhe ndihmës-akademik të kualifikuar për të garantuar standardet e mësimdhënies. Nuk ka të dhëna lidhur me organizimin e ekpive lëndore të mirëfillta.</p> <p><i>(EV. Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut; Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në DS dhe në Fakultetin e Edukimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të UAMD. Stafi në Departamentin e Sociologjisë është përzgjedhur duke treguar rëndësi të veçantë për specializimet e tyre, të cilat përputhen më së miri me zhvillimin e Institucionit. Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të njësive bazë dhe departamenteve, duke përfshirë të gjithë anëtarët e departamentit në këtë proces. Rishikimi dhe përmirësimi i kurrikulës bëhet nga një konsultim i gjerë me anëtarët e departamentit. Në rekrutimin e personelit akademik merren në konsideratë kërkesat ligjore dhe përcaktimet në rregulloren e brendshme.</p> <p><i>(EV. Rregullore e departamentit; Raporti mbi Aktivitetin Kërkimor Shkencor UAMD, për Vitin Akademik 2019- 2020)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) mbështet përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie, duke organizuar konferenca, leksione të hapura, trajnime dhe takime informuese. Procesi mësimor pasurohet nga lektorët, të cilët ndërthurin prezantimet në PowerPoint me përdorimin e fotove dhe videove, duke krijuar një mjedis mësimor ndërveprues dhe tërheqës për studentët.</p> <p><i>(EV. Raporti vjetor I UAMD)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" është një program që u mundëson studentëve të marrin formimin teorik dhe praktik, duke i përgatitur ata për punësim në fushën e shërbimeve sociale dhe komunitare. Megjithatë referuar syllabuseve të lëndëve, objektivave të përcaktuara në to dhe në rregulloren e programit ka vend për përmirësim për të integruar më shumë formim praktik.</p>

	<p>(EV. Analizë e tregut të punës). (EV. Syllabuset e lëndëve)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë kontakton me grupet e interesit, duke marrë në konsideratë nevojat specifike lokale dhe më gjerë, për të ndihmuar studentët të jenë më afër kërkesave të tregut të punës. Zyra e Karrierës dhe Praktikave mban kontakte me studentët e diplomuar dhe krijon një bazë të dhënash për punësimin e tyre. Institucioni mban lidhje me studentët e diplomuar përmes ALUMNI-t, duke marrë prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. Departamenti ka një rrjet bashkëpunëtorësh në fushën e shërbimeve sociale. Është e nevojshme që departamenti të ketë procese dhe procedura periodike të rishikimit të kurrikulës në përputhje me nevojat e tregut.</p> <p>(EV. Udhezues - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Lista e marrveshjeve të bashkëpunimit të departamentit)</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Ky program studimi synon të përgatitë studentët profesionalisht, duke iu ofruar atyre njohuri të nevojshme, aftësi dhe kompetenca për punësim. Struktura e programit është ndërtuar në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Direktivat e Bashkimit Evropian.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit siguron përfshirje të njohurive të thelluara, ndërkombëtarizimit dhe kërkimit shkencor. Personeli akademik është i angazhuar në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe cilësia e procesit mësimor vlerësohet dhe kontrollohet në mënyrë të rregullt. Institucioni mbështet zhvillimin e metodave inovative dhe organizon aktivitete për përmirësimin e njohurive dhe aftësive të studentëve dhe personelit akademik. Megjithatë, ka nevojë për përmirësim në integrimin e formimit praktik dhe në organizimin e ekipeve lëndore të mirëfillta. Departamenti mban kontakte të ngushta me grupet e interesit dhe përmbush kërkesat ligjore dhe direktivat e Bashkimit Evropian për profesionet e rregulluara.</p>

	<p>Mbështetur në analizën e RVB dhe evidencave të vënave në dispozicion ekspertet rekomandojnë edhe përmirësimet e mëposhtme:</p> <p>Departamenti duhet të rishikojë dhe përmirësojë syllabuset dhe objektivat e lëndëve për të integruar më shumë formim praktik dhe për t'u përshtatur më mirë me nevojat e tregut të punës. Konsolidimi i proceseve dhe procedurave periodike për rishikimin e kurrikulës në përputhje me nevojat e tregut dhe rekomandimet e grupeve të interesit është një domosdoshmëri për të ofruar programe në përputhje me nevojat dinamike të tregut të punës.</p> <p>Duhet të organizohen ekipe lëndore të mirëfillta për të garantuar një qasje më të strukturuar dhe të koordinuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në nivel departamenti ose fakulteti.</p> <p>Institucioni duhet të konsolidojë proceset e zhvillimit të vazhduar profesional të stafit akademik për të mbajtur një standard të lartë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Institucioni ka një strukturë të mirëorganizuar dhe një qasje të qartë në përzgjedhjen dhe implementimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies, duke siguruar një proces të gjithanshëm dhe efektiv të mësimnxënies. Përdorimi i metodave të ndryshme është i përshtatshëm për të garantuar një të nxënë cilësor, ndërsa transparenca në prezantimin e programit dhe mënyrës së vlerësimit ndihmon studentët të kuptojnë pritshmëritë dhe objektivat e lëndës. (EV. Syllabusët e lëndëve, Rregullore e programit të studimit, Rregullore e UAMD)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Sociologjisë përpiket vazhdimisht të përmirësojë dijet dhe aftësitë për të përcjellë efektivisht njohuritë tek studentët, duke përshtatur syllabusët me literaturën bashkëkohore dhe përparimet në kërkimin shkencor. Ata inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin mësimor përmes metodave interaktive dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit për prezantime cilësore. Gjithashtu, pedagogët planifikojnë dhe përdorin metoda alternative të mësimdhënies që përfshijnë dhe mbështesin nevojat dhe diversitetin e studentëve. Mbetet ende i paqartë periodiciteti i rishikimit të programeve të studimit dhe procesi i reflektimit të komenteve dhe sugjerimeve të studentëve. (EV. Syllabusët e lëndëve, Rregullore e programit, Raporti vjetor i departamentit)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes strategjive dhe politikave të Fakultetit të Edukimit dhe UAMD-së. Staf i inkurajohet të angazhohet në aktivitete shkencore, mësimore, sociale dhe kulturore, dhe trajnime të organizuara për përmirësimin e aftësive didaktike. Mbështetja e vazhdueshme e institucionit dëshmohet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, që përfshijnë shkëmbimin e personelit akademik dhe nxitjen e projekteve kërkimore shkencore dhe organizimin e konferencave si edhe në mundësitë për financimin e projekteve kërkimore. UAMD ka një qendër për edukimin e vazhduar e cila ofron herë pas here trajnime lidhur me mësimdhënien. Është e nevojshme të ketë procese dhe procedura më të konsoliduara sa i takon kualifikimit të vazhduar të stafit</p>

	<p>akademik lidhur me metodologjitë e mësimdhënies dhe integrimin e teknologjisë në mësimdhënie.</p> <p><i>(EV. Raport vjetor I departamentit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie zotëron aftësitë, njohuritë dhe kompetencat e duhura për t'u përshtatur profilit dhe tematikave përkatëse, duke përdorur metoda të ndryshme mësimore për të siguruar një mësimnxënie efikase dhe duke nxitur mendimin krijues, kritik dhe autonominë e studentëve. Kompetencat e stafit dëshmojnë nga kualifikimet e vazhdueshme dhe CV-të e pasura. Metodatat përfshijnë leksione të hapura, vizita mësimore, aktivitete shkencore, dhe projekte që rrisin angazhimin e studentëve. Për më tepër, organizimi i mësimdhënies në leksione dhe seminare krijon mundësi për diskutime, duke ndërtuar marrëdhënie respekti dhe mbështetje të ndërsjellë.</p> <p><i>(EV. Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët, CV e Stafit Akademik në Master Profesional Shërbime Sociale dhe Komunitare, Analiza pyetësorëve nga studentët, staf akademik, staf administrative, Rregullore e sigurimit të cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit në UAMD, Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Sociologjisë, vlerëson dhe përmirëson metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë mendimet dhe sugjerimet e studentëve. Ky proces kryhet në fund të çdo semestri dhe viti akademik, dhe rezultatet reflektohen në përmirësimin e syllabuseve dhe literaturës, duke integruar teknologjinë bashkëkohore dhe inovacionin për të lidhur mësimnxënien me aspektin praktik pas diplomimit. Një përfaqësues i studentëve në Komisionin e Sigurimit të Cilësisë ndihmon në shprehjen e mendimeve të tyre për përmirësimin e programeve. Marrëdhëniet ndërmjet pedagogëve dhe studentëve karakterizohen nga bashkëpunimi dhe respekti i ndërsjellë, duke synuar ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe edukimin e studentëve me dije të specializuara.</p> <p><i>(EV. Analiza pyetësorëve nga studentët, staf akademik, staf administrative, Rregullore e sigurimit të cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që</p>	<p>Institucioni organizon struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore dhe bazë për përmirësimin e</p>

<p>promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura mbështesin zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe trajnojnë vazhdimisht personelin akademik. UAMD ka ngritur struktura si Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, dhe Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë, të cilat koordinojnë veprimtarinë me fakultetet, departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucionit.</p> <p><i>(EV. Rregullore e NJSBC UAMD, Statuti UAMD, Rregullore e UAMD, Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor të studentëve duke përdorur një strukturë të mirëorganizuar dhe qasje të qartë në përzgjedhjen e metodave të mësimdhënies, të cilat përfshijnë leksione, seminare, punë laboratorike, projekte dhe praktika profesionale. Personeli akademik është i angazhuar në përmirësimin e aftësive dhe kompetencave didaktike, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe përdorimin e metodave interaktive. Institucioni mbështet trajnimin e vazhdueshëm të stafit dhe përfshin mendimet e studentëve në përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies. Strukturat organizative, si Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, koordinojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Megjithatë, është e nevojshme një proces më i konsoliduar për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik dhe për rishikimin periodik të programeve të studimit duke reflektuar komentet e studentëve.</p> <p>Në përfundim të vlerësimit për këtë standard ekspertët rekomandojnë të formalizohet dhe përforcohet procesi i rishikimit periodik të programeve të studimit dhe integrimi i komenteve dhe sugjerimeve të studentëve. Të konsolidohen procedura të qarta dhe struktura mbështetëse për</p>

	kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik, veçanërisht në përdorimin e metodologjive të reja dhe integrimin e teknologjisë në mësimdhënie si dhe të sigurohet një dokumentim më i detajuar i periodicitetit të rishikimit të programeve dhe mënyrës së reflektimit të komenteve të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni ka përcaktuar qartë dhe publikuar kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore nëpërmjet rregulloreve të tij të brendshme, duke përfshirë Rregulloren e UAMD-së, Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Rregullore të posaçme për programet e studimit. Ky proces përfshin elemente si detyra kursi, punë grupi, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, të cilat organizohen dhe kryhen në përputhje me planin mësimor të çdo lënde. Mënyra e vlerësimit dhe testimit përcaktohet dhe bëhet e njohur te studentët në fillim të çdo semestri përmes syllabuseve të lëndëve dhe informacioneve të publikuara në faqen zyrtare të universitetit dhe rrjete sociale të fakultetit. <i>(EV. Rregullore e UAMD, Rregullore e Fakultetit të edukimit, e departamentit, Rregullore e programit të studimit, Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Çdo student informohet në fillim të çdo lënde ose moduli për metodologjinë dhe procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të parashikuara në syllabus. Titullarët e lëndëve/moduleve informojnë studentët në orën e parë të leksionit për strukturën e lëndës dhe përqindjet e pikëve për të gjithë elementët e vlerësimit sipas rregulloreve të UAMD-së, Fakultetit të Edukimit, dhe Rregullores së programit të studimit. Ky proces është i rregulluar dhe i dokumentuar në rregullore dhe në syllabuset e çdo lënde,

	<p>duke siguruar transparencë dhe qartësi për studentët në metodat dhe kriteret e vlerësimit të tyre.</p> <p><i>Mungesa e një sistemi për të identifikuar dhe trajtuar çështjet e plagjiarizmit: Duhet zhvilluar një sistem i përbashkët për identifikimin e plagjiarizmit në detyrat e kursit dhe temat e diplomave dhe më pas një sistem rregullator për trajtimin e këtyre rasteve</i></p> <p><i>(EV. Rregullore e programit të studimit, Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore në UAMD është i organizuar në forma të ndryshme dhe të përshtatshme për të lejuar studentët të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre. Sipas rregulloreve të UAMD-së, Fakultetit të Edukimit, dhe Departamenti i Sociologjisë, si dhe në syllabuset e lëndëve, format kryesore të vlerësimit përfshijnë testimin e ndërmjetëm/detyrat e kontrollit dhe provimin final. Pedagogu informon studentët në fillim të lëndës për kriteret dhe metodat e testimit, duke përfshirë edhe kriteret për pjesëmarrjen në provimin final. Provimet finale organizohen me shkrim dhe përfshijnë kombinimin e pyetjeve me alternativa, pohime, pyetje shpjeguese, dhe zberthim të koncepteve, të përcaktuara në syllabus.</p> <p><i>(EV. Rregullore e Departamentit të Sociologjisë; Rregullore e Programit; Përdorimi i CLEANSCORE në Testime)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton rregullore dhe procedura të posaçme për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Institucioni ka arritur që të përmbushë dhe zbaton me efikasitet kriteret e vlerësimit nëpërmjet rregulloreve të brendshme si Rregullorja e UAMD-së dhe Rregullorja e Fakultetit të Edukimit, si dhe në rregulloret specifike të programit të studimit. Përmes këtyre dokumenteve, UAMD siguron që kriteret dhe metodat e testimit janë të qarta dhe të njohura publikisht nga studentët, duke përfshirë organizimin e detyrave kurse, punës në grup, si dhe provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, të cilat janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve. Pedagogët informojnë studentët në fillim të çdo lënde për strukturën dhe metodat e vlerësimit, duke siguruar që procesi të jetë transparent dhe i kuptueshëm për të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Struktura dhe procesi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale është i rregulluar dhe i qartë në rregulloren e Universitetit, Fakultetit të Edukimit dhe Departamentit, rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve. (EV. Rregullore e UAMD, Rregullore e Fakultetit të Edukimit, Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, Syllabuset në Master Profesional Shërbime Sociale dhe Komunitare)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) përdor sisteme të integruara informacioni, në bashkëpunim me projektin e RASH, për të mbështetur procesin mësimor dhe administrativ. Nëpërmjet sistemit elektronik hidhen rezultatet e vlerësimeve të vazhduara dhe atyre përfundimtare, duke informuar studentët në kohë reale për performancën e tyre dhe duke rritur transparencën. Platforma si CLEANSORE përdoren për teste, duke siguruar një proces të shpejtë dhe të saktë të kontrollit të provimeve. Studentët mund të aksesojnë informacionin e tyre akademik në çdo kohë përmes sekretarisë mësimore ose platformave online, të cilat lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre dhe stafit akademik. Sistemi i menaxhimit garanton ruajtjen e konfidencialitetit dhe përmirëson ndjeshëm shpejtësinë dhe saktësinë e vlerësimeve, duke krijuar një mjedis të besueshëm dhe të orientuar drejt efikasitetit. Përdorimi i Sistemit elektronik; Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin Edukimit; Rregullore e UAMD)
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me	UAMD ka një sistem shumë të organizuar të sistemit të vlerësimit që detajohet në rregulloret e institucionit dhe syllabuset e lëndëve.

<p>syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p><i>(EV. Rregullore e UAMD; Rregullore e Fakultetit të Edukimit, Rregullore e Departamentit, Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rezultatet e provimeve u komunikohen studentëve brenda 72 orësh nga përfundimi i provimit. Ky proces përfshin ballafaqimin e vlerësimit të tezës dhe diskutimin e komenteve për përmirësim nga lektori i lëndës, duke siguruar transparencë dhe mundësi për zhvillim akademik. Ky rregullim është i përcaktuar në nenin 69 të Rregullores së UAMD, nenet 67 dhe 68 të Rregullores së Fakultetit të Edukimit, si dhe në nenin 7 të Rregullores së Departamentit, duke garantuar standarde të larta në administrimin e provimeve dhe komunikimin me studentët.</p> <p>Studentët kanë një periudhë ankimi pasi janë njohur me pikët e tyre në provime. Në kontaktet me pedagogët, studentët njihen me vërejtjet e pedagogëve gjatë korrigjimit.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bëjnë përpjekjet maksimale për të respektuar detyrimet e brendshme rregullatore lidhur me plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Përsa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik orientojnë studentët drejt tematikave kryesisht aplikative ku të dhënat që përdoren të jenë autentike dhe të zhvillojë te studenti qasjen kritike të çështjes së zgjedhur,</p> <ul style="list-style-type: none"> -duke demonstruar njohuritë, aftësitë, - kompetencat dhe përvojën që zotëron student, - demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur, -përdorimin e një metodologjie shkencore dhe të instrumentave të kërkimit etj. Elemente këto që provojnë origjinalitetin e punimit. Në syllabuset e lëndës përcaktohen qartë detyrimet e kodit të etikës lidhur me plagjiarizmin dhe sjelljen në provime. Institucioni gjithsesi nuk ka një sistem kundër plagjiaturës apo identifikimin e plagjiaturës që do i vinte në ndihmë stafit akademik veçanërisht lidhur me detyrat e kursit dhe temat e diplomave. <p><i>(EV. Kodi I Etikës, Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas</p>	<p>Provimet zhvillohen nën vëzhgimin e lektorit ose komisionit të lëndës, me asistencën e një personeli akademik për të siguruar që procesi të jetë i drejtë dhe transparent. Ka një procedurë të përcaktuar qartë në rregulloren e institucionit lidhur me parregullsitë e procesit të provimit. Korrigjimi i provimeve bëhet</p>

<p>përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>nga lektori i lëndës dhe komisioni, sidomos gjatë sezoneve të riprovimeve, duke respektuar afatet për dorëzimin dhe komunikimin e rezultateve me studentët sipas rregulloreve specifike të Universitetit. Në rregulloren e programit të studimit nuk është i përcaktuar afati. Brenda ciklit studentët duhet të njihen me vlerësimin për lëndën.</p> <p><i>(EV. Rregullore e institucionit, rregullore e fakultetit, rregullore e departamentit, rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Universiteti siguron të drejtat e studentëve për të njohur vlerësimin dhe të kërkojnë rishikimin e vlerësimit në përputhje me rregullat dhe procedurat e institucionit. Studentët kanë të drejtën të ankohen në rast se konstatojnë shkelje të rregullave gjatë zhvillimit të provimeve dhe vlerësimit. Ankesa duhet të drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore brenda 3 ditësh kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ose lektori ka detyrimin të mbyllë procesverbalin në sistem me rezultatet përfundimtare.</p> <p>Rishikimi i tezës nga një komision ad-hoc zhvillohet në prezencë të studentit dhe komisionit. Kjo praktikë bazohet në nenin 70, 71, dhe 74 të Rregullores së Universitetit, si dhe në rregulloren e Fakultetit të Edukimit, nenit 69 dhe 72.</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Procedura e ankimit është e përcaktuar qartë në rregulloren e programit të studimit dhe është në përputhje me kriterin. Në rregullore nuk është i qartë specifikimi lidhur me dokumentimin e procedurës së ankimit.</p> <p><i>(EV. Rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent për të gjithë studentët. Kriteret për vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale janë të rregulluara dhe të qarta në rregulloren e Universitetit, Fakultetit të Edukimit dhe Departamentit, si dhe në syllabuset e lëndëve. Implementimi i sistemeve elektronike të vlerësimit, si CLEANSORE në testime, ka rritur transparencën dhe sigurinë duke u mundësuar studentëve qasje të kohës reale në rezultatet e tyre. Procedurat e korrigjimit të provimeve dhe dorëzimit të rezultateve në afatet e caktuara janë të përcaktuara dhe</p>

	<p>zbatohen me përgjegjësi nga personeli akademik, duke iu siguruar studentëve një feedback të detajuar dhe kohë për të kërkuar rishikim në përputhje me rregulloret e institucionit.</p> <p>Për të përmirësuar proceset e vlerësimit, rekomandohet që Universiteti të përmirësojë dokumentimin dhe arkivimin e procedurave të ankimimit në rregullore, për të garantuar transparencën dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve. Gjithashtu, është e rekomandueshme që të zhvillohet një sistem i përbashkët për identifikimin e plagjaturës në detyrat e kursit dhe temat e diplomave, për të rritur integritetin akademik dhe për të siguruar që të dhënat e përdorura janë autentike dhe origjinale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Program i studimit është i natyrës gjenraliste, ka nevojë për thellim më të madh të njohurive dhe specializim në një fushë më specifike. Literatura e përdorur gjithashtu ka nevojë për përditësim të vazhdueshëm në përputhje me literaturën bashkëkohore ndërkombëtare por edhe me raportet studimore kombëtare e lokale për të sjellë studentët me afër realitetit të shërbimeve sociale dhe problemeve të komunitetit. Në syllabuset e lëndëve detajohen forma të ndryshme të organizimit të procesit mësimor të lidhur kryesisht me format e vlerësimit.</p> <p><i>(EV. Plani mësimor, syllabuset e lëndëve)</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe	<p>Programi synon pajisjen e studentëve me njohuri, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e aftësive të veçanta në administrimin efikas të organizatave të ndryshme. Gjithashtu, programi u ofron mundësinë studentëve që të fokusohen në një numër të caktuar fushash specifike të shërbimeve humane, sociale dhe komunitare si: shëndet mendor, edukim, ndihmë sociale, ndërmjetësim dhe shërbim publik.</p>

<p>ndërveprimi (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Aftësitë e përfituara do t'u mundësojnë studentëve të jenë të aftë të nxiten të zhvillojnë aftësitë e tyre këshilluese dhe profesionale, për t'u ardhur në ndihmë individëve me nevoja të ndryshme.</p> <p><i>(EV. Syllabuset e lëndëve, Plani mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton student, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik vlerëson përmbushjen e objektivave të lëndës dhe aftësitë e studentëve përmes provimeve dhe detyrave të kursit. Në përfundim të çdo lënde apo moduli, personeli akademik bën një analizë të qartë të realizimit të mësimin sipas planit mësimor dhe syllabuseve, duke identifikuar çështjet kryesore dhe temat më të rëndësishme që lidhen me lëndën. Ata ofrojnë një përmbledhje të këtyre temave, duke përfshirë raste praktike dhe rekomandime për studentët për të përmirësuar zbatimin e tyre në praktikë dhe për t'u përgatitur për provimin përfundimtar.</p> <p><i>(EV. Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në Departamentin e Sociologjisë mësimdhënia realizohet në baza të kompetencave që ndihmojnë studentët të zhvillojnë njohuritë e tyre në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik kultivon diskutimet dhe punën në grup për interpretimin dhe zgjidhjen e çështjeve të kompleksuara, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore dhe shkencore. Ata gjithashtu integrojnë formate të mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të rritur mobilizimin e studentëve dhe për të siguruar një përvojë më të pasur mësimore dhe kërkimore në fushën e sociologjisë. Nëpërmjet marrëveshjeve bashkëpunuese, personeli akademik përfiton njohuri të reja dhe aftësi, duke siguruar një ndërthurje efektive të metodave të ndryshme mësimore dhe duke nxitur studentët të marrin pjesë në projekte dhe aktivitete të mobilitetit studentor.</p> <p><i>(EV. Vendim për grupet e punës në Konferencën e FE 2020/2022; Raporti mbi Aktivitetin Kërkimor Shkencor UAMD; Mobilitetet UAMD; Relacion per aktivitetet studentore, Konferencat Studentore, Workshop-e në Fakultetin e Edukimit, DS, Viti Akademik 2020-2021; Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me</p>	<p>Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, dhe për tu dhënë atyre njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat</p>

<p>kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>profesionale e shkencore, personeli akademik i Departamentit të Sociologjisë, në vazhdimësi ka realizuar orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja në shkencë dhe teknologji brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit. Këto aktivitete organizohen me qëllim që të rrisin aftësitë krijuese dhe aplikative të studentëve, duke u siguruar në të njëjtën kohë njohuri dhe kompetenca të nevojshme profesionale dhe shkencore. Personeli akademik fton specialistë dhe ekspertë të fushës për të kontribuar në leksione të hapura dhe seminare, duke krijuar hapsirë për diskutime të thella dhe inteligjente mbi çështje që lidhen me sociologjinë dhe fushat e ngjashme studimore.</p> <p><i>(EV. Konferencat Studentore, Workshop-e në Fakultetin e Edukimit, DS, Viti Akademik 2020-2021; Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) dhe Fakulteti i Edukimit (FE) kanë organizuar në mënyrë të vazhdueshme konferenca shkencore dhe konferenca shkencore të studentëve, ku studentët janë inkurajuar të marrin pjesë aktivisht, shpesh duke paraqitur punime shkencore si rezultat i bashkëpunimit të tyre me personelin akademik. Ky bashkëpunim ka qenë i rëndësishëm për të mbështetur dhe zhvilluar aftësitë e tyre kërkimore.</p> <p>Për të rritur aftësitë krijuese dhe zbatuese të studentëve, si dhe për t'u dhënë atyre njohuri dhe kompetenca profesionale e shkencore, personeli akademik i UAMD ka ndërthurur metodat e mësimdhënies me bashkëpunime institucionale. Këto bashkëpunime, që përfshijnë edhe mobilitete studentësh, janë realizuar në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Sociologjisë kanë organizuar një gamë të gjerë aktiviteteve shkencore dhe mësimore, duke inkurajuar gjithmonë përfshirjen aktive të studentëve. Angazhimi i tyre ka ndihmuar në shtimin dhe pasurimin e aktiviteteve nga viti në vit, duke kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të një mjedisi akademik të gjallë dhe mbështetës.</p> <p><i>(EV. Model i paraqitjes së aktiviteteve të zhvilluara; Relacion per aktivitetet studentore, Konferencat Studentore, Workshop-e në Fakultetin e Edukimit, DS, Viti Akademik 2020-2021; Vendim</i></p>

	<i>për grupet e punës në Konferencën e FE 2019; Mobilitetet UAMD)</i>			
Konkluzione	Programi i studimit në Departamentin e Sociologjisë synon të garantojë rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët, duke zhvilluar kompetenca profesionale dhe shkencore të thelluara. Eskpertët rekomandojnë thellim më të madh të njohurive dhe specializimin në fusha specifike të shërbimeve humane dhe sociale. Rekomandohet një përditësim i vazhdueshëm i literaturës për të rritur përputhshmërinë me zhvillimet më të fundit në fushën bashkëkohore dhe lokale. Syllabuset dhe planifikimet mësimore duhet të përfshijnë më shumë variacione në format e vlerësimit për të reflektuar më mirë qëllimet dhe objektivat e lëndëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Procedura për diplomimin e studentëve është e bazuar në Rregulloren e Fakultetit, si dhe në Rregulloren së Tezës së Diplomës dhe në rregulloren e diplomimit. Studentët informohen përpara procesit të diplomimit. <i>(EV. Rregullore e Fakultetit të Edukimit; Rregullore e Tezës së Diplomës në Fakultetin e Edukimit; Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Edukimit)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti i Sociologjisë, si strukturë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi dhe personeli akademik asistojnë studentët me qëllim që atyre tu krijohen të gjitha kushtet për të mbyllur me sukses provimin final apo mbrojtjen e diplomës. Strukturat përgjegjëse kanë detyra dhe përgjegjësi të qarta për informimin e studentëve lidhur me procesin e diplomimit dhe detyrimeve përmbyllëse. <i>(EV. Rregullore e diplomimit)</i>

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studentët e programit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” përfundojnë studimet përmes mbrojtjes së tezës së diplomës. Procesi i vlerësimit realizohet nga komisionet përkatëse, të cilat marrin në konsideratë disa aspekte kryesore: cilësinë dhe përmbajtjen e punimit të paraqitur në formë të shkruar, aftësinë e studentit për të prezantuar temën gjatë mbrojtjes, si dhe përgjigjet e tij ndaj pyetjeve të anëtarëve të komisionit. Vlerësimi përfundimtar jepet mbi bazën e këtyre elementeve dhe reflektohet në notën e diplomës.</p> <p><i>(EV. Rregullore e diplomimit.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Anëtarët e Departamentit të Sociologjisë janë të angazhuar për të asistuar dhe këshilluar studentët në përzgjedhjen dhe zhvillimin e temave të diplomës, përmes takimeve në orare specifike dhe ditë të caktuara. Përveç kësaj, udhëheqësi shkencor luan një rol kyç në përzgjedhjen e temës dhe në mbikëqyrjen e procesit të punës kërkimore të studentit, duke ofruar këshilla dhe udhëzime të vazhdueshme.</p> <p>Këto procedura janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Tezës së Diplomës dhe Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, duke garantuar një proces të strukturuar dhe të drejtë. Udhëheqësi shkencor siguron mbështetje të mjaftueshme dhe udhëzime të detajuara për hartimin dhe përmbushjen me sukses të tezës së diplomës, duke respektuar të gjitha kërkesat dhe standardet e rregullores përkatëse.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni siguron që studentët të kenë mbështetje dhe këshillim të nevojshëm përmes udhëheqësit. Udhëheqësi i studentit asiston, ndihmon dhe këshillon atë nëpërmjet pajisjeve dhe programeve që disponon fakulteti, të cilat janë reflektuar në detaje në Rregulloren e Tezës së Diplomës në Fakultetin e Edukimit dhe në Rregulloren e Diplomimeve në Fakultetin e Edukimit, si dhe Rregulloren e programit.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të</p>	<p>Vlerësimi i tezës së diplomës realizohet nga një komision, i cili i referohet Rregullores së Tezës së Diplomës dhe Modelit të Vlerësimit të përcaktuar për këtë proces. Komisioni jep vlerësim përfundimtar bazuar në modelin e vlerësimit të tezës së diplomës.</p>

diplomës, studenti vlerësohet me notë.									
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Procesi i pajisjes me diplomë gjithashtu është parashikuar në rregulloren e sekretarisë, fakultetit dhe të Universitetit (nenet 76 - 79 të Rregullores së UAMD, nenet 73 -77 të Rregullores së Fakultetit të Edukimit). Pas diplomimit studenti ka të drejtë të marrë edhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara. EV. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Edukimit.								
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan një kopje të dokumentacionit të studentëve, duke garantuar akses dhe ruajtje të sigurt sipas rregullave në fuqi. Studentët, sipas kërkesës së tyre, mund të paraqiten për të marrë informacion mbi dokumentacionin e tyre, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Rregulloren për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit në UAMD dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Edukimit. Ky proces siguron transparencë dhe akses të drejtë për studentët.								
Konkluzione	<i>Institucioni demonstroi përpjekje të konsiderueshme për të plotësuar këtë standard duke hartuar dhe bërë publike procedurat e diplomimit dhe detyrimet përfundimtare. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ofrojnë mbështetje të konsiderueshme për studentët në të gjitha fazat e procesit të diplomimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive,

Në aftësimin profesional të studentëve të programit të studimit në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” përfshihen praktikat profesionale të cilat realizohen në institucione publike dhe private në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe në organizata të cilat operojnë në fushën

<p>garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>shërbimeve sociale rezidenciale dhe ditore. Praktikrat profesionale janë në përputhje me objektivat e programit dhe për realizimin e tyre janë lidhur marrëveshje me institucione sociale.</p> <p><i>(EV. Lista e marrveshjeve në funksion të praktikave profesionale)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Sociologjisë kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizuar praktika profesionale dhe për të shkëmbyer eksperiencën në dobi të zhvillimit të programit dhe institucionit. UAMD ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh në nivel lokal rajonal dhe ndërkombëtar, ofron edhe mobilitet për studentët. Rrjeti i marrëveshjeve të praktikës profesionale sjell institucione publike dhe ojf ku studentët mund të aftësohen gjatë realizimit të praktikës profesionale.</p> <p><i>(EV. Lista e marrveshjeve në funksion të praktikave profesionale)</i></p>
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Në planin mësimor janë përcaktuar qartë kreditet për kryerjen e praktikës profesionale. Numri i orëve që studneti duhet të kryejë praktikë është gjithashtu i përcaktuar por raporti orë studimi individual dhe orë praktikë në institucion duhet të ndryshojë duke rritur orët e praktikës në institucion. Nuk është i qartë në rregulloren e praktikës roli i mentorit të praktikës profesionale dhe kriteret e përzgjedhjes së tij. Rregullorja e praktikës ka nevojë të rishikohet përtej kornizës së institucioneve të edukimit duke qenë se edhe praktika për këtë program masteri rrallë bëhet në institucione arsimore dhe ka natyrë tjetër nga programet në fushën e edukimit. Gjithashtu është e rekomandueshme që përveç lëndës së praktikës profesionale, orë specifike ose komponentë të praktikës profesionale mund të integrohen edhe në programet e lëndëve karakterizuese të programit mësimor për ta afruar sa më shumë aftësimin e studentëve me tregun e punës.</p> <p><i>(EV. Plani mësimor, Rregullore e praktikës profesionale)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>UAMD në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse dhe partnerët e tjerë, ka hartuar një strukturë për realizimin e praktikave profesionale. Këto përfshijnë praktikrat profesionale në institucione publike dhe private, si dhe organizata që operojnë në fushën e shërbimeve sociale dhe</p>

	komunitare, duke u siguruar që të përshtaten me objektivat dhe standardet e programit. Megjithatë, për të përmirësuar standardin dhe për të përmbushur plotësisht kërkesat, rekomandohet rishikimi i rregulloreve për praktikat profesionale për të përfshirë qartësi më të madhe në rolin e mentorëve të praktikës, kriteret e përzgjedhjes së tyre, si dhe rishikimin orëve të praktikës profesionale si lëndë dhe integrimin e orëve praktike edhe në programet e tjera lëndore të natyrës karakterizuese. Kjo do të siguronte një përmirësim në integrimin e aftësive praktike në programet akademike dhe përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1							
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe	Angazhimi i personelit akademik është realizuar bazuar në kërkesat dhe modalitetet e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.						
	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK

angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Prof.Dr	1		1		1	
	Prof.As.Dr	1		1		1	
	Dr	7		7		7	
	MSc	0		0		0	
	Total	9	0	9	0	9	0

Përbërja e personelit akademik të departamentit të angazhuar në 3 vitet e fundit akademike në programin e studimit, paraqitet si në vijim:

- 20-21: **10 PAE**, me kualifikimin: 1 Prof.Dr ;1 Prof.As., 7 Dr., dhe 1 Dr. Proc dhe **0 PAK**.
- 21-22: **10 PAE**, me kualifikimin: 1 Prof.Dr ;1 Prof.As., 8 Dr., dhe **0 PAK**,
- 22-23: **9 PAE**, me kualifikimin: 1 Prof.Dr ;2 Prof.As., 6 Dr., dhe **0 PAK**,

GVJ evidenton se në të dhënat e paraqitura nga IAL lidhur me personelin akademik ka disa pasaktësi/mospërputhje.

Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është i kualifikuar dhe zotëron tituj akademikë dhe grada shkencore, si dhe ka një eksperiencë të pëlqyeshme në mësimdhënie. Pedagogët e përfshirë në program, sipas cv dhe syllabuseve të depozituara nga secili mësimdhënës, kanë kontribute shkencore në fushat që mbulojnë, si punime doktorature, trajnime afatgjata dhe afatshkurtra, mësimdhënie në fusha të njëjta, përafërta apo të ngashme por jo të gjithë janë të lidhur me fushën e punës sociale.

Evidenca_Nr.69_ (Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit MP Shërbime Sociale dhe Komunitare
Evidenca_Nr.66_ (Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje	Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Të dhënat që ka paraqitur Departamenti i Sociologjisë për planifikimin e ngarkesës për çdo vit akademik dhe për realizimin e ngarkesës mësimore tregojnë qartë respektimin e kornizës ligjore në fuqi. Personeli akademik me kohë të plotë mbulon jo më pak se 70% të
--	---

<p>me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>ngarkesës mësimore për çdo program studimi. Përkatësisht, për 3 vitet e fundit akademike, ngarkesa paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 20-21: 100 % PAE / 0 % PAK; - 21-22: 100 % PAE / 0 % PAK; - 22-23: 100 % PAE / 0 % PAK. <p><i>Evidenca_Nr.65_ (Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit MP Shërbime Sociale dhe Komunitare Dosja e programit të studimit</i> <i>(Evidenca_Nr.23_ (Dosje Riorganizimi MP Shërbime Sociale dhe Komunitare Viti 2021, Dosja e programit të studimit: Kurrikula, Struktura mësimore, Plani mësimor, Syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Kontratat e personelit dëshmojnë përmbushjen e këtij kriteri. Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me stafin e burimeve njerëzore, u evidentua se Departamenti i Sociologjisë garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohet nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata pa afat dhe është i punësuar pranë IAL prej shumë vitesh, si dhe i angazhuar në këtë program që prej ditës së parë që programi është hapur, e cila u konfirmua edhe nga vizita në institucion dhe diskutimi me stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program. Procedura për rekrutimin e personelit akademik është e reflektuar në Statutin e Universitetit dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. Institucioni nëpërmjet DBNJPA ndjek në mënyrë rigoroz procedurat në bashkëpunim me Departamentin.</p> <p><i>Evidenca_Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD). Shiko tek: rrregullore-drejtoria-burimeve-njerezore-dhe-juridike.doc (live.com) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.23_ (Dosje RiOrganizimi MP Shërbime Sociale dhe Komunitare Viti 2021, Dosja e programit të studimit: Kurrikula, Struktura mësimore, Plani mësimor, Syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe</p>	<p>UAMD rekruton personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (nenet 64-67), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregulloren dhe Statutin e UAMD.</p> <p>Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësues dhe administrativ. Në Statutin e UAMD, Rregulloren e Përgjithshme të UAMD dhe Rregulloret e tjera përcaktohen qartë të gjitha procedurat për rekrutimin e stafit akademik për realizimin e programit të studimit. Përzgjedhja e personelit akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi është bërë sipas nevojave të Departamentit, i cili ka përcaktuar paraprakisht me vendim të veçantë kriteret specifike për vendet e punës.</p> <p>GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit</p> <p><i>Evidence. Të dhëna nga faqja zyrtare e web e UAMD (www.uamd.edu.al)</i></p> <p><i>Evidenca Nr. 10. 1_Dosja e procedures se rekrutimit. (Rregullore për Rekrutimin e Stafit akademik, Nidhmës dhe Administrativ në Uamd, praktika të rekrutimit.)</i></p> <p><i>Evidenca Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD). Shiko tek: rrregullore-drejtoria-burimeve-njerezore-dhe-juridike.doc (live.com) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, dhe Fakulteti i Edukimit siguron punësimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe realizimin e orëve laboratorike dhe të mjediseve të tjera mësimore referuar rregullores së institucionit dhe strukturës organizative të tij. Numri i personelit ndihmës akademik i angazhuar në këtë program studimi është 0</p> <p>UAMD ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike. Të gjitha njoftimet publikohen duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca Nr.8_ (Rregullore e Departamentit të Sociologjisë)</i></p> <p><i>Evidenca Nr. 10. 1_Dosja e procedures se rekrutimit. (Rregullore për Rekrutimin e Stafit akademik, Nidhmës dhe Administrativ në Uamd, praktika të rekrutimit.)</i></p>

<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit dhe ruan përshkrimet e punës, bashkëpunon me Rektoren dhe Administratorin për plotësimin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar si dhe ndjek zbatueshmërinë e procedurave të punësimit të personelit të deri në firmosje të kontratës së punës; kjo zyrë ruan të dhënat zyrtare sipas akteve ligjore në fuqi. Mbledhja e të dhënave bëhet mbi bazën e një formulari tip, i cili plotësohet nga personeli me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet me një dosje personale fizike, që përditesohet në bazë të informacionit të paraqitur në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> <p>Departamenti Sociologjisë ka përdorur rregullisht një sërë mekanizmash dhe procesesh formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e këtij programi studimi.</p> <p>GVJ kontrollon në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe evidenton se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.</p> <p><i>Evidenca Nr.66_ (Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse.</i></p> <p><i>Evidenca Nr.69_ (Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Departamentin e Sociologjisë dhe në Fakultetin e Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca Nr.2_ (Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025)), https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf, fq 3,4</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për</p>	<p>Të dhënat e paraqitura për këtë program studimi tregojnë se UAMD dhe Fakulteti i Edukimit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit. Kapacitetet e UAMD-së dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike në përmbushje të praktikës profesionale dhe në funksion të punimit të temës së diplomës. Në kuadër të procesit të kryerjes së praktikës profesionale, UAMD dhe Departamenti i Sociologjisë janë angazhuar në realizimin e marrëveshjeve me organizata të ndryshme në nivel</p>

<p>instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>vendor apo qëndror <i>GVJ rekomandon vijimin e angazhimit nëpërmjet marrëveshjeve me palët e treta për të mundësuar e udhëhequr praktikën e studentëve, kjo nëpërmjet marrëveshjeve të cilat adresojnë në mënyrë specifike këtë program studimi.</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.45_ (Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Edukimit</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.45.1_ (Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit, në UAMD)</i></p> <p><i>Evidence_45.4_ (Modeli i vlerësimit të performancës së praktikës studentore)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.15_ (Rregullore Praktikes Profesionale në Fakultetin e Edukimit)</i></p> <p><i>Evidence mbi dosjen e praktikave profesionale.</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësimin të studentëve për të realizuar jo vetëm aplikimin e njohurive praktike, por edhe zhvillimin e mendimit kritik si dhe të aftësive kërkimore të tyre. Programi i studimit nëpërmjet praktikës synon të ofrojë njohuritë e nevojshme për studentët që synojnë të vazhdojnë formimin e tyre akademik. Praktikave profesionale të cilat realizohen në institucione publike dhe private në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe në organizata të cilat operojnë në fushën shërbimeve sociale rezidenciale dhe ditore. Praktikave profesionale janë në përputhje me objektivat e programit dhe për realizimin e tyre janë lidhur marrëveshje me institucione sociale.</p> <p>Njësia Bazë përcakton koordinatorin përgjegjës, i cili mbikëqyr ecurinë dhe zhvillimin e programit. Koordinatorin përgjegjës i programit të studimit, mban kontakte të vazhdueshme me stafin akademik, ndihmës akademik, Zyrën Vendore Arsimore si dhe me studentët e programit të studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p><i>Evidence mbi dosjen e praktikave profesionale.</i></p> <p><i>Evidenca mbi Rregullore e Praktikes profesionale</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Jo i gjithë personeli akademik që mbulon programin e studimit ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. GVJ evidenton se në të dhënat e paraqitura nga IAL lidhur me personelin akademik ka disa pasaktësi/mospërputhje. GVJ rekomandon vijimin e angazhimit</i></p>

	<i>nëpërmjet marrëveshjeve me palët e treta për të mundësuar e udhëhequr praktikën e studentëve, kjo nëpërmjet marrëveshjeve të cilat adresojnë në mënyrë specifike këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Në Fakultetin e Edukimit procesi mësimor kryhet në 15 auditorë me kapacitet total 1141 vende dhe me sipërfaqe 1374.2 m² dhe 1 laborator me kapacitet 64 vende dhe sipërfaqe 81.8 m². Gjithashtu ka në dispozicion 16 zyra me sipërfaqe totale 483.9 m². Për aktivitete të ndryshme disponon salle konferencash me kapacitet 218 vende me sipërfaqe 192.2 m². Fakulteti ka në dispozicion biblioteke me kapacitet 126 vende, me sipërfaqe 238.8 m².</p> <p>Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila shërben edhe si zyrë mbledhjesh dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse në godina të të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre.</p> <p>GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambjent të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme.</p> <p><i>Evidenca_Nr.97_(Infrastruktura, Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit, laboratoreve, laboratoreve TIK të Fakultetit të Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.96_(Vlerësimi i Kapaciteteve)</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të	Mjediset mësimore të (UAMD) përfshijnë bibliotekën, laboratorin e informatikës, laboratorin e linguistikës, të cilat janë të pajisura me pajisje moderne si laptopë, desktopë, monitorë dhe projektorë ndersa në sallat e leksioneve mungojnë. <i>Nxitet pajisja e pasurimi i</i>

<p>pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p><i>mëtejshëm i këtyre mjediseve edhe me mjete të tjera e pajisjet më të fundit teknologjike dhe pajisja e çdo auditori me video-projektor sepse infrastruktura moderne teknologjike lejon pedagogët dhe studentët të përdorin mësimdhënie më efektive dhe të përshtatshme për nevojat e tyre të mësimin. Për shembull, përdorimi i projektorëve dhe monitorëve gjatë leksioneve mundëson prezantime të qarta vizuale dhe demonstrime praktike. Laptopët dhe desktopët e disponueshëm në laboratorë dhe bibliotekë mundësojnë kërkim akademik dhe punë të projekteve në mënyrë efikase. Gjithashtu, mjediset e pajisura mirë teknologjikisht kontribuojnë në përmirësimin e shkëmbimit të informacionit dhe njohurive mes studentëve dhe stafit akademik. Kështu, UAMD ka mundësinë për të patur një ambient të përshtatshëm për përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përfshirë teknologjinë në çdo hap të procesit mësimor.</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.97_(Infrastruktura)</i> <i>Evidenca_Nr.91_(Licensimi i programeve kompjuterike)</i> <i>Evidenca_Nr.96_(Vlerësimi i Kapaciteteve)</i> <i>Evidenca_Nr.97_(Infrastruktura, Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit, laboratoreve, laboratoreve TIK të Fakultetit të Edukimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit ofron mjedise mësimore të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme për realizimin e kërkesave të moduleve, zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike, si dhe arritjen e objektivave të programit të studimit. Auditorët e Fakultetit janë të pajisur me teknologji dhe infrastrukturë bashkëkohore, të dizajnuara për të plotësuar nevojat e lëndëve dhe moduleve, duke siguruar një mjedis optimal për mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p><i>Evidenca_Nr.97_(Infrastruktura, Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit, laboratoreve, laboratoreve TIK të Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.87_(Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit)</i> <i>Evidenca_Nr.96_(Vlerësimi i Kapaciteteve)¹</i> <i>Evidenca_Nr.97_(Infrastruktura, Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit, laboratoreve, laboratoreve TIK të Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.91_(Licensimi i programeve kompjuterike)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së</p>	<p>Laboratori i Informatikës pranë Fakultetit të Edukimit në UAMD është një burim i rëndësishëm për studentët që ndjekin programe</p>

<p>paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>studimi në fushën e teknologjisë së informacionit. Ky laborator është i pajisur me një varietet mjeteve moderne që sigurojnë një mjedis të përshtatshëm për mësimdhënie efektive dhe zhvillim praktik të njohurive.</p> <p>Laboratori, i cili ndodhet pranë sallës 101, disponon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Audio (1) • Kompjuterë (6) • Hard disk (1) • Hub (1) për shpërndarjen e linjës • Paketemausi me wireless (1) • Laptopë (2) • Printer me ngjyra (1) • Server Web (1) • Smart board (1) • Vidio-projektor (1) <p>Kjo bazë laboratorike e kompletuar ofron platformën ideale për të realizuar me sukses leksionet dhe praktikat laboratorike në kuadër të programeve studimore të fakultetit. Për studentët, njohuria dhe aftësimi në teknologjitë e informacionit janë thelbësore, dhe laboratori i Informatikës në UAMD siguron një ambient të përshtatshëm për këtë qëllim. Programet profesionale të instaluar në kompjuterat e këtij laboratorit, të cilat janë të licensuara, përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi Statistikor SPSS Version 22 • Paketa Office, duke përfshirë Excel, Word dhe aplikacione të tjera të nevojshme për punën akademike dhe profesionale. <p>Kështu, laboratori ofron një gamë të gjerë mundësish për studentët për të zhvilluar aftësitë e tyre teknologjike dhe për të përfutur njohuri thelbësore që i ndihmojnë ata në karrierën e tyre të ardhshme.</p> <p><i>Evidenca Nr.91 (Licensimi i programeve kompjuterike)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në</p>	<p>Për të përshpejtuar dhe përmirësuar procesin mësimor, Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Sociologjisë nënshkruajnë në mënyrë të vazhdueshme marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike</p>

<p>bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>dhe organizata të ndryshme. Ky bashkëpunim shtrihet në fushën e mësimdhënies dhe përfshin shkëmbim të njohurive dhe inovacionit në mesin e studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Për sa i përket ambientit fizik, megjithëse ka synime për kontrata të reja të ambienteve, aktualisht nuk janë realizuar për shkak se nevojat infrastrukturore në ambientet e kampusit universitar plotësohen. UAMD angazhohet të përmirësojë këto kushte dhe të sigurojë ambiente të përshtatshme dhe moderne për të gjithë përdoruesit e saj në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca_Nr.45_ (Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.45.1_ (Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Sociologjisë në UAMD)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL është e përshtatshme, garanton realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin teorik dhe atë praktik, të posaçëm referuar natyrës dhe fushës së studimit. Nxitet pajisja e pasurimi i mëtejshëm i këtyre mjediseve edhe me mjete të tjera më të fundit teknologjike dhe pajisja e çdo auditori me video-projektor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe</p>	<p>Rektorati i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) garanton mbështetjen financiare për pasurimin dhe zhvillimin e bibliotekës universitare. Aktualisht, fondi i bibliotekës përmban rreth 12,000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, të disponueshëm si në format fizik ashtu edhe elektronik, duke mbuluar të gjitha</p>

<p>digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Fakultetet e universitetit. Përveç kësaj, biblioteka përmban një koleksion të rëndësishëm të periodikëve shqiptarë të botuar gjatë viteve 1944-2003 dhe është e abonuar në disa revista shkencore, duke ofruar burime të vlefshme për studime dhe kërkime akademike. Biblioteka e universitetit ka tre vendndodhje. Ajo në Godinën Universitare në Currila që i shërben Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Fakultetit të Studimeve Profesionale. Biblioteka Nr. 2, pranë Godinës nr. 1 në Kampusin Universitar i shërben Fakultetin e Edukimit. Një hapësirë tjetër dhe sallë leximi ndodhet në Godinën nr. 2 të kampusit. Si një bibliotekë me fonde të hapura dhe hibride, ajo ofron kërkim të informacionit online, salla leximi, skedarë elektronikë, si dhe lehtësira për kërkimin bibliografik dhe shfletimin e literaturës elektronike në kompjuterat e sallës. Fondet e bibliotekës pasurohen vazhdimisht edhe nga dhurimet e materialeve nga stafi akademik dhe administrativ i UAMD-së, të cilët botojnë materiale shkencore dhe akademike. Të gjithë titujt në koleksionin fizik dhe online të bibliotekës janë të qasshëm për studentët e të gjitha cikleve studimore të universitetit.</p> <p><i>Evidenca _Nr. 124_ (Fondi i librit).</i> <i>Evidenca _Nr.82_ (Biblioteka Online, të dhëna mbi materialet e disponueshme.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Biblioteka e universitetit njofton për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit qoftë në gjuhën shqipe dhe atë të huaj. Plani financiar i programit të studimit përmban zëra të veçantë për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës për programin e studimit.</p> <p>Nga RVB dhe takimet në Departament evidentohet fakti që Departamenti i Sociologjisë diskuton dhe miraton programet mësimore të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit lidhur me përditësimin e literaturës dhe ndjek botimet e reja nga të gjitha burimet që disponon, sidomos ato që lidhen drejtëpërdrejtë me kurrikulën e programit të studimit me synimin për t'i përditësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien.</p> <p><i>Evidenca _Nr. 124_ (Fondi i librit).</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit është e hapur për të gjithë studentët dhe siguron mundësinë për shfrytëzim dhe akses për të gjithë ata që ndjekin programet e studimit në Fakultetin e Edukimit (FE). Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës (UAMD) ka implementuar libraritë elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale të ndryshme ndërkombëtare. Kjo bibliotekë është në dispozicion të studentëve, duke siguruar mundësinë e përdorimit të barabartë për të gjithë ata që janë pjesë në programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.88_ (Rregullore e Bibliotekës)</i> <i>Evidenca_Nr.51_2 (Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library).</i> <i>Evidenca_Nr.51_ (Lista e teksteve në Bibliotekë për programin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit të Edukimit ofron një gamë të gjerë të materialeve në format printimi në gjuhën shqipe dhe angleze, duke përfshirë tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra dhe revista shkencore, si dhe burime të tjera akademike Megjithatë, referuar evidencave mbi fondin e bibliotekës dhe vleresimeve të syllabyseve rezulton se <i>nuk ka mjaftueshëm literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe në atë angleze (tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme) të 5 viteve të fundit , ndaj rekomandohet vijimi i përditësimit dhe pasurimit të saj me literaturë të aksesueshme e në përshtatje me nevojat e formimit specifik të këtij programi studimi</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.51_ (Lista e teksteve në Bibliotekë për programin e studimit)</i> <i>Evidenca_Nr. 124_ (Fondi i librit).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton e krijon kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online në dispozicion të programit të studimit. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konfirmoi UAMD ka anëtarësim të plotë në JSTOR. UAMD është abonuar në libraritë elektronike si EBSCO, biblioteka digjitale që përmbajnë revista akademike që mund të aksesohen lirish nga studentët dhe stafi akademik. UAMD është gjithashtu pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike on line) një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore. Si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri, përmes projektit ERA2012</p>

	<p>(Electronic resources for Albania) lexuesit përfitojnë akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë. UAMD fitoi statusin “EU Info Point” me anë të së cilës mbërrinjë në bibliotekën e UAMD periodikisht publikime nga Zyra e Publikimeve të BE-së në Luksemburg. Biblioteka e UAMD është pjesë e ALASE (Albanian Academic Recherche Engine)</p> <p>Çdo anëtar i personelit akademik dhe student ka akses në koleksionet e U-Library dhe mund të aksesojnë disa artikuj në mënyrë periodike.</p> <p><i>Evidenca Nr.88 (Rregullore e Bibliotekës)</i> <i>Evidenca Nr.81 (Manual Biblioteka Online)</i> <i>Evidenca Nr.82 (Biblioteka Online, të dhëna mbi materialet e disponueshme)</i> <i>Evidenca Nr.71 (Digital Library – Universiteti Aleksandër Moisiu)</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e UAMD është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Biblioteka ofron lehtësira dhe logjistikën e duhur që mundësojnë shfrytëzimin optimal të saj. Koleksioni përpunohet nga ana shkencore bibliografike konform standardeve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50 SRU.</p> <p><i>Evidenca Nr.88 (Rregullore e Bibliotekës)</i> <i>Evidenca Nr.97 (Infrastruktura)</i> <i>Evidenca Nr.91 (Licensimi i programeve kompjuterike)</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit. Biblioteka e FE, ka si qëllim të vendos në dispozicion të studentëve orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre. Gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjeruar.</p> <p><i>Evidenca Nr.88 (Rregullore e Bibliotekës)</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ-së gjatë bisedës ju konfirmua se çdo student dhe lektor ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studentëve i vihet në dispozicion kartela e regjistrimit me të dhënat personale dhe pajiset me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave, për lundrim në burimet elektronike, ose</p>

<p>dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>përdorimin e katalogut elektronik. Biblioteka e Universitetit ka instaluar falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj.</p> <p>Çdo vit, sipas kërkesave të stafit akademik përgatitet lista e blerjeve për të pasuruar fondin e Bibliotekës. Kërkesat evidentohen në Departament të cilët në fillim të vitit akademik diskutojnë programet e lendëve, ndryshimet, përmirësimet dhe përcaktojnë kërkesën për literaturën. Nga takimi me stafin u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsideratë kërkesat e tyre për literaturë plotësuese po për këtë vit akoma nuk ishte miratuar lista e librave të kërkuar nga departamenti.</p> <p><i>Evidenca_Nr.88_(Rregullore e Bibliotekës)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentëve të programit të studimit, u ofrohet infrastrukturë e përshtatshme për procesin e mësimnxënies. Rekomandohet pasurimi e përditësimi me literaturë i bibliotekës për programin e studimit në proces vlerësimi. GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e cila duhet marrë vëmendje nga njësia bazë, të analizohet dhe të ndërtohen plane konkrete veçanërisht për fondin fizik të literaturës së 5 viteve të fundit, pasi kështu mund të mundësohet pasurimi i fondeve dhe përditësimi i literaturës në fushën e punës sociale, e cila është domosdoshmëri për procesin e formimit teorik të studentëve në këtë program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të</p>	<p>UAMD përmban informacion personal të studentit dhe adresat e tyre elektronike. Studentët gjithashtu, informohen nga faqja zyrtare e UAMD, rrjetet sociale, në ambientet brena godinës si dhe nga sistemi</p>

<p>cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Pitagora. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka faqen zyrtare zonën e studentit. AULA dhe Pitagora - RASH është një sistem menaxhimi për studentët që ofron funksionalitetet e nevojshme për sekretariatë dhe administratën, si dhe për studentët dhe stafin akademik. Ky sistem menaxhon të gjithë ciklin akademik të studentëve, nga regjistrimi në kurse dhe vlerësimet deri te diplomimi, duke përfshirë gjithashtu transferimet ndërmjet universiteteve, gjithashtu përmban informacion në lidhje me: të dhënat e studentit, shkëmbime dhe praktika, orari, lidhshipi studentor, zyra e komunikimit Alumnit dhe karrierës, bursa dhe tarifa, etj. Përmes sistemit të integruar “Pitagora” parashikohet realizimi i komunikimit midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve dhe informacionit</p> <p><i>Evidenca_Nr.67_ (Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në Ciklin e I & II që ofron Departamenti i Sociologjisë)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.68_ (Të dhëna të plota për MP SHSK për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, VA 2018-2019)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.86_ (Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.67_ (Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në Ciklin e I & II që ofron Departamenti i Sociologjisë)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.68_ (Të dhëna të plota për MP SHSK për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, VA 2018-2019)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.103_ (Sistemi AULA dhe Pitagora - RASH)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti administrojnë dokumentacionin përkatës për partnerët dhe për stafin e angazhuar në këtë program studimi. Sistemi i UAMD-së për ruajtjen e informacionit të personelit bazohet në arshivimin e dokumentacionit në formën hardcopy dhe elektronike dhe kjo ka rezultuar efektive. Përmes Sistemit të brendshëm të Menaxhimit në UAMD, zbatohen politika të ruajtjes së të dhënave dhe përpilimi të statistikave me të dhënat e studentëve nga ana e sekretarisë mësimore si dhe regjistrave hard-copy.</p> <p>Përsa i përket aspektit administrativ, përgjegjësitë për pranimin dhe regjistrimin e studentëve, menaxhimin e studentëve që hyjnë dhe</p>

<p>angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>dalin, si dhe organizimin e provimeve në UAMD, janë në duar të sekretarive mësimore. Të dhënat ruhen në mënyrë të plotë dhe anonime, dhe ndarja e informacionit me individë të paaautorizuar është e ndaluar.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore ruan CV-të, ngarkesat dhe dokumenta të tjera të nevojshme që lidhen me veprimtarinë e personelit.</p> <p><i>Evidenca Nr.17_ (Rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UAMD)</i> <i>Evidenca Nr.64_ (Raporti mbi Aktivitetin Kërkimor Shkencor UAMD, për Vitin Akademik 2019- 2022)</i> <i>Evidenca Nr.65_ (Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit MP, SHSK)</i> <i>Evidenca Nr.69_ (Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Departamentin e Sociologjisë dhe në Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca Nr.107_ (Procedura për rekrutimin e stafit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Platforma Pitagora mundëson transmetimin e vlerësimit të dijeve të studentëve nga lektori te studenti. Platformë prezente edhe në ciklin e dytë. Bëhet i mundur komunikimi dhe përcjellja e informacionit tek studentët, gjithashtu siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë personelin akademik dhe administrativ. Pas zhvillimit të provimit, lektori paraqet rezultatet e studentëve online. Nota e provimit bëhet e disponueshme për secilin student në mënyrë individuale, dhe ata njoftohen për rezultatin menjëherë pas publikimit të notave nga pedagogu përkatës, përmes një emaili personal.</p> <p>Studentët kanë mundësi të kryejnë veprimtaritë e nevojshme, si regjistrimi në provime, printimi i syllabuseve të lëndëve, dhe ndjekja e frekuentimit dhe mungesave. Aksesit në dokumente dhe informacion është i garantuar për personelin dhe studentët, si në mënyrë fizike ashtu edhe virtuale, përmes web-it, email-it dhe zonës së studentëve në faqen e internetit, bazuar në sistemin e përdorimit elektronik.</p> <p><i>Evidenca Nr.11_ (Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca Nr.90_ (Përdorimi i Sistemit elektronik)</i> <i>Evidenca Nr.17_ (Rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UAMD)</i> <i>Evidenca Nr.103_ (Sistemi AULA dhe Pitagora – RASH, Manuali i përdorimit të sistemit AULA dhe Pitagora-RASH)</i></p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Platforma Pitagora mundëson transmetimin e vlerësimit të dijeve të studentëve nga lektori te studenti. Platformë prezente edhe në ciklin e dytë.</p> <p>Përmes Pitogorës, lektori i lëndës/modulit komunikon me studentët sipas kërkesave të tyre, duke përdorur opsionet dhe platformave të integruara në sistemin e menaxhimit. Lektori raporton të dhëna mbi frekuentimin e seminareve dhe ushtrimeve nga studentët, duke ofruar informacione të detajuara si analiza e eseve, detyrave të kursit dhe çdo informacion tjetër të lidhur me lëndën/modulet që ndjekin studentët. Po ashtu, në hapësirën e tij "Profili i Pedagogut", lektori ka mundësinë të shënojë vendet dhe oraret e takimeve me studentët.</p> <p><i>Evidenca Nr.103_ (Sistemi AULA dhe Pitagora - RASH)</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Fakulteti ka zhvilluar struktura që mundësojnë monitorimin dhe raportimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Sistemi i Menaxhimit të Studentëve siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit të personelit akademik, duke përfshirë frekuentimin e lëndëve dhe vendosjen e notave nga lektori. Këto informacione transmetohen menjëherë në faqen personale të studentëve në sistemet Aula dhe Pitagora-RASH.</p> <p><i>Evidenca Nr.37_ (Memo, Vendim per Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca Nr.11_ (Rregullore e Sekretarisë Mësimore ne Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca Nr.86_ (Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)</i> <i>Evidenca Nr.87_ (Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit)</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare e UAMD përmban të gjitha informacionet mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Njësia kryesore ka ngritur struktura të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ</p> <p><i>Evidenca Nr.108_ (Të dhëna nga faqja zyrtare e Web-it e UAMD)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit është i kompletuar dhe mbështetës në vijimësinë e aktiviteteve të institucionit për programin e studimit në proces vlerësimi.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Buxheti financiar në nivel institucioni bëhet çdo vit. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas Cikleve dhe programeve të studimit. Planifikimi i financimit realizohet në mënyrë paraprake për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.113.1_Raport i veprimtarise ekonomiko- financiare 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidenca_Nr. 124_ (Publikimi i Raportit 2021- 2022);</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe përmban të gjithë elementët financiarë në bazë programi. Plani i financimit të programit të studimit përmban elementet dhe zërat specifike për financimin e tij, si: orë mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shpenzimet e ndryshme operative etj., kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe çdo zë tjetër të nevojshëm.</p> <p>Plani i financimit të programit të studimit përmban të gjitha elementet dhe zërat specifike për financimin e tij, si: orët mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shpenzimet e ndryshme operative, etj.</p> <p><i>Për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve të programit, do të këshillojm që njësia bazë të aftësohet në proceset e financimit, shpenzimeve, detyrimeve financiare apo dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, për të garantuar edhe në këtë drejtim autonominë e njësisë bazë, sipas frymës së ligjit.</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të përvitshme të dokumentuara që dëshmojnë vlerësimin financiar të institucionit, bazuar në raportet e auditimit dhe të dhënat financiare. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka për detyrë realizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me planet e miratuara. UAMD kryen auditim të veprimtarisë nga njësitë e auditimit të brendshëm. Institucioni ka raporte auditimi të brendshëm çdo vit. Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të përvitshme të dokumentuara që dëshmojnë efektivitetin financiar të UAMD. Përsa i përket kostos së programit të studimit Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare”, përlllogaritja e kostos mbështetet në llogaritjet për shpërndarjen e ngarkesave mësimore të lektoreve sipas planit mësimor, shpenzime të stafit ndihmës akademik që angazhohen në programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.93_ (Raporti i Veprimtarisë Audituese V.A. 2013-2021)</i> <i>Evidenca_Nr.93_ (Raporti i Veprimtarisë Audituese V.A. 2013-2021)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik. Plani i financimit hartohet në nivel institucioni dhe përmban elementët financiarë për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit të studimit.</p> <p>Institucioni raporton në mënyrë periodike për realizimin e buxhetit, për rishikimin dhe për rialokimin e buxhetit, sipas ligjit mbi buxhetin. Institucioni harton Raport Financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar</p> <p>UAMD raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik.</p> <p><i>Evidenca_Nr.93_ (Raporti i Veprimtarisë Audituese V.A. 2013-2021)</i> <i>Evidenca_Nr.113.1_ (Vendim Bordi mbi riorganizimin me të dhënat financiare mbi koston e Programit SHSK)+ Raport i veprimtarisë ekonomiko- financiare 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e</p>	<p>Të dhënat financiare dëshmojnë se institucioni siguron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për gjenerimin e të</p>

<p>programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>ardhurave gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe për të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca_Nr.93_ (Raporti i Veprimtarisë Audituese V.A. 2013-2021)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Garantohet financimi dhe mbështetja financiare e nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtja e programit të studimit dhe mbështetja e studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga</p>	<p>Pranimi i studentëve në këtë program studimi është paraqitur në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Bazuar në parashikimet në aktet e brendshme rregullatore të UAMD, vihet re se në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës procesi që nga hyrja deri në daljen e studentëve në të gjithë ciklin e studimit, mbështetet në politika dhe procedura të cilat janë në respektim të plotë të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të institucionit. Konkretisht për regjistrimet në</p>

<p>hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>këtë cikël studimi, pranohen studentët bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së miratuara nga MAS. Departamenti i Sociologjisë përgatit dhe miraton kuotat dhe kriteret e pranimit për programin e studimit. Këto kritere publikohen në faqen zyrtare të UAMD. Numri i studentëve dhe shpërndarja e tyre përcaktohen në përputhje me tabelën e kuotave të pranimit. Institucioni informon studentët për programin e studimit dhe kriteret e pranimit përmes aktiviteteve të ndryshme, si ditët e informimit, panairt e punës, dhe takimet në shkolla.</p> <p><i>Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare"</i> ¹ <i>Evidenca_Nr.110</i> <i>(Njoftime për studentet)</i> <i>Evidenca_Nr.10_(Rregullore e NJSBC UAMD).</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit, GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UAMD nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Respektohen detyrimet ligjore mbi regjistrimin, dhe ngrihet një komision ad hoc, i cili pas shqyrtimit të listës së aplikantëve shpall dhe listën e kandidatëve fitues për programin e studimit..</p> <p><i>Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD). https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare"</i> <i>Evidenca_Nr.10_(Rregullore e NJSBC UAMD). shiko tek: https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e</p>	<p>Nga evidencat e vëna në dispozicion dhe raportimi i GVB, institucioni ka një praktikë të mirëpërcaktuar në baza vjetore për kriteret e kandidatëve për programin e studimit</p>

<p>kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik Departamenti i Sociologjisë në bashkëpunim me strukturat përkatëse në FE hartojnë dhe bëjnë publike kriteret e veçanta dhe specifike për tu pranuar në këtë program studimi¹ Zyra e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit përgjatë gjithë orarit zyrtar, pa kufizime, informojnë studentët rreth nevojave dhe kërkesave të tyre. Studentët informohen për të gjitha detajet e programit të studimit. Ky informim realizohet në çdo fillim viti, duke iu shpërndarë studentëve një paketë informacioni orientuese si guidën dhe fletëpalosjet përkatëse, në tavolina në afërsi të sallave të leksioneve ku studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm.</p> <p><i>Evidenca_Nr.76_ (Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD) shiko tek: rregullore-drejtoria-burimeve-njerezore-dhe-juridike.doc</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL, konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi dhe ka edhe një Vendim senati për kuotat. Për studentët që ndjekin programin e studimit në Master profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” departamenti në bashkëpunim me FE harton kriteret dhe procedura të përzgjedhjes së studentëve që janë lehtësisht të kuptueshme dhe që mund të aksesohen lehtësisht nga gjithë të interesuarit</p> <p>Nga materialet në dispozicion dhe praktikës së mënyrës së funksionimit të procedurave të ndryshme përfshirë edhe pranimin e përzgjedhjen e studentit, programi i transparencës në universitetin “Aleksandër Moisiu” mbështetet në parimin e të drejtës për informim që është një e drejtë kushtetuese të cilën e gëzon çdo person për tu njohur me informacionin publik në përputhje të ligjit për të drejtën e informimit mbi statutin e UAMD, rregulloren si dhe në kodin e Etikës së tij, etj.</p> <p><i>Evidenca_Nr.68_ (Të dhëna të plota MP Shërbime Sociale dhe Komunitare për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje)</i> <i>Faqe zyrtare e departamentit</i></p>
	<p><i>Evidenca_Nr.1_ (Statuti i UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-</i></p>

¹ Evidenca_Nr.47_ (Memo për Kriteret e Pranimit të Studentëve) KRITERET-2024-2025-UAMD.pdfkriteret-2024-2025-UAMD.pdf

	<p><i>UAMD.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.9_ (Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare")</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Para fillimit të çdo viti akademik, kandidatët për studentë, të interesuarit dhe publiku i gjerë marrin informacion të detajuar mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në programet e studimit. Në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Edukimit dhe Njësia Bazë përgjegjëse sigurojnë publikimin dhe qartësinë e këtyre kriterëve, duke përdorur strategji të marketingut dhe komunikimit për të garantuar informimin e gjerë dhe transparent të palëve të interesuara. Nëpërmjet kanaleve të mjetëve të komunikimit bëhet i mundur informimi i publikut të interesuar. GVJ gjatë vizitës në IAL konfirmoi organizimin e ditëve të informimit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.47_ (Memo për Kriteret e Pranimi të Studentëve)</i> <i>KRITERET-2024-2025-UAMD.pdf</i> <i>kriteret-2024-2025-UAMD.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.74_ (Programi i Transparencës UAMD)</i> <i>Evidenca_Nr.76_ (Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqa zyrtare e Web-it të UAMD)</i> <i>Evidenca_Nr.89_ (Strategjia e Komunikimit UAMD)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Kriteret e pranimi të studentëve në këtë program studimi janë të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, këto kriteret bëhen të qarta dhe publike. Kriteret pasi shqyrtohen në dekanat, i përcillen Senatit Akademik, i cili merr vendimin përkatës dhe publikohen në faqen zyrtare të UAMD. Për sa i përket kuotave, ato i përcillen Bordit të Administrimit për miratim. Pas përfundimit të procedurës nga IAL-ja, kriteret dhe kuotat i përcillen MAS në afatet e përcaktuara. IAL ka të përcaktuara gjithashtu edhe kuota të veçanta për kandidatë të kategorive të veçanta, shtresave të marginalizuara apo kandidatë të trojeve.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Kriteret e hartuara për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve në Master profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" publikohen në faqen on-line të website zyrtar të UAMD-së, me qëllim që publiku i interesuar ta marrë këtë informacion si dhe nëpërmjet zyrës së sekretarisë mësimore UAMD në tërësi, FE dhe Departamenti i Sociologjisë ndjekin politika mbështetëse për ecurinë e studentëve. Për programin e studimit ndiqen</p>

	<p>politika marketingu të cilat e bëjnë atë transparent me publikun e interesuar.²</p> <p><i>Evidence _ 47_1. Memo Mbi kriteret e pranimit dhe kuotat e pranimit. KRITERET-2024-2025-UAMD.pdf</i> <i>kriteret-2024-2025-UAMD.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.47_ (Memo për Kriteret e Pranimit të Studentëve), Mbi politikat e pranimit. KRITERET-2024-2025-UAMD.pdf</i> <i>kriteret-2024-2025-UAMD.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UAMD ndjek një politikë mbështetëse për studentët e kategorive sociale të veçanta. Për këtë kategori, parashikohen kriteret për përfitimin e bursave bazuar në aktet ligjore në fuqi dhe rregulloret e brendshme të UAMD. Kriteret dhe informacioni për përfitimet publikohen në faqen zyrtare dhe iu komunikohen nga strukturat e UAMD të interesuarve edhe me kanale të tjera komunikimi dhe me komunikim të drejtpërdrejtë. Studentët plotësojnë Formularë Aplikimi për Trajtimin me Bursë.</p> <p><i>Evidenca_Nr.47_ 2. Ndihma shoqerore & subvencione Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës - UAMD shiko ketu: Ndihma shoqerore & subvencione - Universiteti "Aleksandër Moisiu" (uamd.edu.al)</i> <i>Evidenca_Nr.47_ 4. Formular-aplikimi-për-bursë-UAMD-2020-2021-1.docx (live.com)</i> <i>Evidenca_Nr.47_ 3. Bursa Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës - UAMD. Shiko tek: Bursa - Universiteti "Aleksandër Moisiu" (uamd.edu.al)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të qarta, publike dhe të aksesueshme nga palët e interesuara për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

²Faqe zyrtare e departamentit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Departamenti nëpërmejt sistemit Pitagora mundëson një menaxhim të integruar të dhënave për programin akademik dhe kurrikulën përkatëse të programit të studimit, stafin akademik dhe studentët. Baza ligjore e njësisë përkatëse që menaxhon programin e studimit, gjithashtu parashikon nevojën e ofrimit të një informacioni të plotë dhe transparent për programin e studimit si kurrikula e studimeve, plani mësimor, programet mësimore të moduleve përbërëse; rregullorja e programit të studimit si dhe gjithë veprimtaritë formuese që lidhen me këtë program studimi.</p> <p>Kalimi nga një vit akademik në tjetrin dhe progresi akademik i studentëve në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës mundësohet nëpërmjet ofrimit të një informacioni të plotë dhe transparent. GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës.</p> <p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD) . https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.9_ (Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare")</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme janë të përcaktuara nga institucioni dhe të kuptueshme e të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe për të gjithë të interesuarit.</p> <p>Të dhëna për kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme publikohen edhe në takime me studentët nga departamenti dhe në faqen zyrtare web</p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.9_ (Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare")</i> <i>Evidenca_Nr.74_ (Programi i Transparencës UAMD)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni gjendet nëpërmjet faqes zyrtare të UAMD, faqeve sociale të fakultetit, broshurave dhe katalogut studentor si edhe gjatë shpërndarjes dhe shpjegimit të syllabuseve. Gjithashtu nëpërmjet zyrave alumni, sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë mësimore, informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive në programin e studimit.</p>

	<p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD). https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.13_ (Java e orientimit Uamd /Fakultetin e Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.24.1_ (Plani Mësimor në MP Shërbime Sociale dhe Komunitare V.A. 2020-2022)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.14.1_ (Rregullore e Mikrotezës në Fakultetin e Edukimit))</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se, bazuar në Rregulloren e UAMD; rregulloren e Fakultetit, kriteret dhe procedurat e diplomimit të programit të studimit janë të përcaktuara, të kuptueshme dhe aksesueshme nga studentët duke vënë në dispozicion strukturat përkatëse përgjegjëse ashtu edhe kanale e mjete të ndryshme komunikimi.</p> <p>Baza ligjore respektive është e plotë dhe e aksesueshme në nivel institucional dhe njësie përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqja zyrtare e Web-it të UAMD)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD). https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Oferta akademike për programin e studimit promovohet nga institucioni sipas bazës ligjore në fuqi. Përpara fillimit të procesit të plotësimit të formularit të pranimit në Institucionin e Arsimit të Lartë, UAMD ofron informacion dhe materiale promovuese, si fletëpalosje dhe orientim për maturanët që zgjedhin të vazhdojnë studimet në UAMD. Sekretaritetë mësimore dhe Zyrën e Alumni janë në dispozicion për të ofruar mbështetje dhe informacion. Për më tepër, organizohen vizita dhe aktivitete promovuese me grupe lektorësh për të informuar dhe orientuar të interesuarit.</p> <p>Vlen për tu përmendur iniciativa e njësisë bazë për të vijuar procesin e promovimit tek targeti i studentëve të ardhshëm të interesuar nëpërmjet fletpalosjeve, faqes zyrtare të internetit të UAMD dhe rrjeteve sociale.</p> <p><i>Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqja zyrtare e Web-it të UAMD)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.76_ (Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Edukimit)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Përmes dokumenteve bazë, si dhe angazhimit në nivel përgjegjës departamenti për programin e studimit organizohen takime informuese dhe orientuese me studentët, në të cilat prezantohen elementët e programit të studimit, plani mësimor, kohëzgjatja e programit, struktura e institucionit, kjo në bashkëpunim me zyrat përkatëse <i>Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqa zyrtare e Web-it të UAMD)</i> <i>Evidenca_Nr.76_ (Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Edukimit)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Edukimit dhe Njësia përgjegjëse për programin e studimit ofrojnë akses të plotë dhe transparent në dokumentacionin dhe udhëzuesit për lëndët/module. Ky informacion përfshin përmbajtjen e lëndëve dhe aktivitetet formuese të lidhura, dhe përditësohet vazhdimisht. Transparenca sigurohet përmes të dhënave të disponueshme në faqen zyrtare të internetit, politikave institucionale për publikimin e informacionit, politikave të komunikimit, si dhe Planit Mësimor në MP "Shërbime Sociale dhe Komunitare" dhe Kurrikulës Mësimore në Master Profesional në "Shërbime Sociale dhe Komunitare". <i>Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqa zyrtare e Web-it të UAMD)</i> <i>Evidenca_Nr.24.1_ (Plani Mësimor në Master profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare")</i> <i>Evidenca_Nr.76_ (Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Edukimit)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ofron mbështetje të plotë institucionale për orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, si strukturë përgjegjëse e institucionit, informon, orienton dhe këshillon studentët në lidhje me mundësitë për praktika mësimore, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe mundësitë e punësimit, në përputhje me Rregulloren e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.

	<p>Në nivel organizativ, UAMD ka ngritur Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës me qëllim kryesor mbështetjen dhe orientimin e studentëve në lidhje me karrierën e tyre. Një nga detyrat funksionale të kësaj zyre është evidentimi i të dhënave të studentëve të vitit të fundit në ciklet e ndryshme të studimeve dhe gjurmimi i ecures së tyre në tregun e punës. Për të lehtësuar mundësitë e punësimit të studentëve, UAMD ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme. Po mungonte informacioni lidhur me shërbimet që ofron Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p><i>GVJ rekomandon që Zyra e Karrierës duhet të zgjerohet dhe shtohet me burime njerëzore. Gjithashtu duhet të rritet numri i orëve të praktikës profesionale jo vetëm në lëndën e praktikës por edhe në lëndët e tjera mund të shihet mundësia për shtimin e orëve praktike dhe duhet të rritet numri i organizatave bashkëpunuese në fuksion të praktikës profesionale</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqja zyrtare e Web-it te UAMD Evidenca_Nr.86_ Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres) Planifikimi_Strategjik_Karriera.pdf (uamd.edu.al), Udhezuesi_i_Karrieres.pdf (uamd.edu.al) Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqja zyrtare e Web-it të UAMD) Evidenca_Nr.78_ Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, së bashku me Fakultetin e Edukimit, si një ndër njësitë kryesore të tij, ofron gjatë takimeve dhe seancave orientuese informacion të plotë për studentët lidhur me logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që mbështesin procesin e tyre të studimit.</p> <p>Ky informacion është gjithmonë i aksesueshëm dhe përcillet vazhdimisht përmes Sekretarisë Mësimore, Koordinatorit të Programit dhe platformave të ndryshme të komunikimit, duke siguruar mbështetje të plotë dhe qasje të lehtë për studentët.</p> <p><i>Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqja zyrtare e Web-it te UAMD) Evidenca_Nr.89_ (Strategjia e Komunikimit UAMD) Strategjia_e_Komunikimit.pdf Evidenca_Nr.90_ (Përdorimi i Sistemit elektronik</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të</p>	<p>Fakulteti i Edukimit, përmes strukturave të tij dhe sistemit të menaxhimit të informacionit, ka mundësuar që informacioni mbi programin e studimit të Masterit Profesional “Shërbime Sociale dhe Komunitare” të jetë i disponueshëm për të gjithë studentët, ai siguron akses të vazhdueshëm dhe të thjeshtë në të dhëna të përditësuara mbi</p>

brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	programin e studimit, duke qenë lehtësisht i arritshëm nga çdo vend. <i>Evidenca_Nr.68_ (Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, ne programin e studimit SHSK.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi objektivat formuese të secilës lëndë; kishin informacion të hollësishëm për strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit por mungonte informacion lidhur me shërbimet që ofron Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. GVJ rekomandon që Zyra e Karrierës duhet të zgjerohet dhe shtohet me burime njerëzore. Gjithashtu duhet të rritet numri I orëve të praktikës profesionale jo vetem në lëndën e praktikës por edhe në lëndët e tjera mund të shihet mundësia për shtimin e orëve praktike dhe duhet të rritet numri i organizatave bashkëpunuese në fuksion të praktikës profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UAMD dhe Njësia bazë përgjegjëgjëse disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. GVJ vizitoi sekretarinë mësimore ku mbahen rregjistrat në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. <i>Evidenca_Nr.68_ (Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, ne programin e studimit SHSK.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre,	Statistikat e vëna në dispozicion nga institucioni dëshmojnë informacion të plotë nga regjistrimi në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar, etj, duke u bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e UAMD. Statistikat e përgatitura ruhen në hard dhe soft

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>copy. Të dhënat statistikore dërgohen brenda afateve të përcaktuara pranë drejtorisë së Statistikave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Të dhënat e numrit të studentëve për tre vite akademike për programin e studimit MP në "Shërbime Sociale dhe Komunitare" janë si më poshtë: V.a 2020-2021:17 studentë V.a 2021-2022: 14 studentë V.a 2022-2023: 8 studentë</p> <p><i>Evidenca Nr.68_ (Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, ne programin e studimit SHSK.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, të dhënat për studentët janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat ruhen konform akteve rregullore të Universitetit. Të dhënat statistikore të studentëve përgatiten dhe ruhen elektronikisht si edhe në dosje fizike nga personat e autorizuar. Me përfundimin e sezonit të provimeve apo riprovimeve dhe depozitimit të procesverbaleve me notën përfundimtare, kryesekretaret në bashkëpunim me sekretaret mësimore kryejnë pasqyrimin e notave në bazën elektronike të të dhënave konformë manualit për funksionimin e sekretarisë.</p> <p><i>Evidenca Nr.6_ (Rregullore e UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i> <i>Evidenca Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca Nr.11_ (Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca Nr.1_ (Statuti i UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton</p>	<p>Mbështetja e procesit të kontrollit periodik është qartësisht e evidentuar në bazën ligjore në nivel institucioni e njësie. Nxitet vijueshmëria e procesit të kontrollit periodik pranë njësive përkatëse për menaxhimin e informacionit. UAMD ka hartuar manualin për funksionimin e sekretarisë mësimore ku shpjegon qartë jo vetëm saktësinë për ruajtjen e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, por edhe mënyrën e kryerjes në mënyrë periodike të kontroleve për vlerësimin e të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin, përfshirë</p>




<p>gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.</p> <p><i>Evidenca_Nr.6_(Rregullore_e_UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.7_(Rregullore_e_Fakultetit_të_Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.11_(Rregullore_e_Sekretarisë_Mësimore_në_Fakultetin_e_Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.1_(Statuti_i_UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës përpilon të dhëna tabelore në mënyrë të vazhdueshme për profilet, cilësinë dhe formimin e studentëve në hyrje dhe në dalje, duke analizuar e diskutuar mundësitë e përmirësimit të tyre.</p> <p>Nuk ka ndonjë studim të mirëfilltë të fokusuar të njësisë bazë për studentët që mbarojnë këtë profil. Sidoqoftë, nje vlerësim i përgjithshëm i tregut, vlerësimi i deritanishëm i punësimeve të studentëve të këtij programi që janë diplomuar më parë është i dobishëm për ecurinë e programit dhe Institucioni i ka kapacitetet për ta realizuar këtë aspekt.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</i></p> <p><i>Nuk ka ndonjë studim të mirëfilltë të fokusuar të njësisë bazë për studentët që mbarojnë këtë profil. Meqënëse fusha dhe tregu i mundshëm i punës i të diplomuarve të këtij programi është i larmishëm, institucioni të vazhdojë të testojë e studiojë më në gjërësi tregun dhe të adresojë treguesit e studimit siç duhet për studentët e rinj në programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>UAMD, në përputhje me aktet ligjore, përfshirë Ligjin 20/2015 “Për Arsimin e Lartë” dhe aktet nënligjore si Statuti i UAMD, Rregullorja e Fakultetit të Edukimit dhe Rregullorja e Departamentit, përfshin studentë dhe përfaqësues të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të universitetit, sipas numrit të përcaktuar nga këto akte rregullatore. Studentët e UAMD-së janë të përfaqësuar në organet drejtuese të universitetit, si Senati, dhe në nivel fakulteti në komisione si Komisioni i Etikës dhe Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Këto struktura funksionale janë të zgjedhura në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015. Përfaqësuesit studentë japin opinionin e tyre për planet dhe programet mësimore, si dhe për çështje të etikës dhe të tjera.</p> <p><i>Evidenca_Nr.1_ (Statuti i UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.9_ (Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare")</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë vizitës GVI konfirmoi se përfshirja e studentëve mundësohej nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë për vlerësimin e procesit akademik, i cili është një proces që kryhet në mënyrë të pavarur për secilin pedagog në fund të semestrit.</p> <p>Studenti ka të drejtë të japë vlerësimin e vet në mënyrë të pavarur dhe pa praninë e pedagogut të lëndës në auditor në momentin e vlerësimit.</p> <p>Procedurat e pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentëve e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje janë prezente.</p> <p>Nxitet analiza e vazhdueshme e impaktit real të angazhimit studentor në nivele të ndryshme të procesit vendimmarrës në institucion</p>

	<p><i>Evidenca_Nr.41_ (Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar)</i> <i>Evidenca_Nr.1_ (Statuti i UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga feedback-u i marrë ndryshimi i kurrikulave realizohet në mënyrë periodike e të qendrueshme. Megjithatë opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e mësimdhënies, orareve, shpërndarjes së provimeve etj.</p> <p>Studentët kanë të drejtën e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca_Nr.41_ (Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar)</i> <i>Evidenca_Nr.39_ (Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët)</i> <i>Evidenca_Nr.83_ (Anketimi i studentëve për stafin akademik dhe administrativ)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve që janë pjesë e programit të studimit në Master Profesional në “Shërbime Sociale dhe Komunitare” u është mundësuar, nëpërmjet anektitimit të tyre me anë të pyetësorëve, proces ky i cili realizohet në çdo fund semestri, të japin mendimet e tyre, në mënyrë të pavarur e të pandikuar mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p>GVJ konstatoi se ky informacion ju bëhej me dije studentëve dhe u konfirmua po ashtu edhe gjatë takimit me studentët, të cilët pohuan se kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevojë. Pyetësorët e studentit dhe mundësia e ankimit janë si mekanizma të shprehjes së opinionit dhe ushtrimit të së drejtës lidhur me procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p><i>Evidenca_Nr.9_ (Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare")</i> <i>Evidenca_Nr.39_ (Formulari i vlerësimit për lektorët nga studentët)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se ka një harmonizim ndërmjet bazës ligjore e parashikimeve përkatëse në të me proceduat rutinë të përfaqësimit</i></p>

	<i>e integritit të zërit studentor në funksion të përmirësimit të cilësisë në aspektin e mësimdhënies, vendimmarrjes, ofertës akademike në tërësi për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>UAMD ka krijuar strukturën e vet, e cila u siguron studentëve mbështetjen e nevojshme akademike, vë në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet (Sekretaritet, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI). Njësia përgjegjëse për informimin e studentëve në FE është Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e Informacionit. Fakulteti i Edukimit pasqyron të gjitha aktivitetet në faqen zyrtare të facebook.</p> <p>Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve</p> <p><i>Evidenca_Nr.108_ (Të dhëna nga faqja zyrtare e Web-it e UAMD)</i> <i>Evidenca_Nr.95_ (Struktura UAMD 2019)</i> <i>Evidenca_Nr.74_ (Programi i Transparencës UAMD)</i> <i>Evidenca_Nr.89_ (Strategjia e Komunikimit UAMD)</i> <i>Strategjia_e_Komunikimit.pdf (uamd.edu.al)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë	<p>Drejtoria e Garantimit të Standardeve dhe Cilësisë tërheq përmes pyetësorëve dhe anketimeve mendimet dhe idetë e studentëve lidhur me procesin mësimor e programet e studimit.</p> <p>Zyra e Këshillimit dhe Karrierës ofron shërbime këshillimore dhe orientuese në dobi të studentëve por që nuk është plotësisht i plotë, pasi studentët nuk e njihnin mirë rolin e plotë të zyrës.</p> <p>Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, por ka në dispozicion edhe një sistem menaxhimi i cili është në dispozicion të çdo studenti. Në javën e parë</p>

<p>me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>të çdo viti akademik departamentet organizojnë informimin e studentëve të vitit të parë mbi çështjet administrative nga zyrat kryesore administrative të Universitetit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD). https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i> <i>Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD). https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i> <i>Udhezuesi_i_Karrieres.pdf (uamd.edu.al)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Sektorit të Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, GVJ u informua se, bazuar në Rregulloren e Sektorit të Komunikimit, Alumni & Karrierës, si edhe Raporteve vjetore, Sektori i Karrierës dhe Alumni është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për aktivizimin e potencialeve të tyre, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore. Gjithashtu në këtë kuadër ky sektor, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat statistikore. <i>Por, sikurse cituar dhe në kriterin më lart, roli i kësaj zyre nuk është plotësisht i plotë, pasi studentët nuk e njohnin mirë rolin e saj.</i></p> <p><i>Udhezuesi_i_Karrieres.pdf (uamd.edu.al)</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët edhe pas diplomimit duke aktivizuar edhe rrjetin alumni bazuar në Rregulloren e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës. Sektori i Komunikimit, Alumni & Karrierës ofron jo vetëm vendosjen e kontakteve me Alumni të UAMD me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t'i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash, por edhe ftesën për Alumni të suksesshëm për të zhvilluar orë të hapura leksioni apo seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme; Ish studentët (alumni), që kanë arritur një nivel të lartë profesional, propozohen për “Çmimin e Karrierës”, i cili synon të promovojë</p>




	arritjet e tyre dhe të shërbejë si shembull për të gjithë ata që do të mbarojnë studimet pranë UAMD siç evidentohet në Raportin e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit. GVJ konfirmon që zyra nuk ka mundur të zhvillojë çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar, pasi stafi në dispozicion nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk mund të realizohej një gjurmim i tillë për të gjithë programet.			
Konkluzione	<i>UAMD ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme, por GVJ vëren se këto procedura e njësi nuk janë lehtësisht të arritshme nga studentët dhe prezente e funksionale në institucion.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Njësia kryesore/bazë ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron. Fokusi i veprimtarisë së kësaj zyre është evidentimi i problematikave të lidhura me mësimin, evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies, sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies, vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore etj.. GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përbushje të kërkesave të ligjit, të cilat kanë

	<p>objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme në mbështetje të Rregullores së NJBSC.</p> <p><i>Evidenca_Nr.2_ (Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025)</i>), https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf, fq 3,4.</p> <p><i>Evidenca_Nr.1_ (Statuti UAMD)</i> https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë ka hartuar, ndjekur dhe zbatuar politika dhe procedura për pranimin, vlerësimin dhe monitorimin e dijeve dhe diplomimin në këtë program studimi.</p> <p>Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. - Përgjegjësjë e departamentit dhe Dekani vlerësojnë në mënyrë të strukturuar performancën e lektorëve gjatë vitit akademik në fund të secilit vit akademik. - pyetësorët vlerësues të stafit akademik. <p>Gjithashtu zhvillimi i sistemit të sigurimit të cilësisë përfshin vetë-analizën; treguesit e cilësisë; vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve; vlerësimin e studentëve, vlerësimin e programeve mësimore; vlerësimin e pjesëmarrjes në veprimtarinë kërkimore; vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve nacionale, rajonale dhe më gjerë.</p> <p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese që ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD</p> <p><i>Evidenca_Nr. 128_Vendim Nr. 57, Dt. 25.05.2020 "Miratim i anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë"</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.39_ (Formulari i vlerësimit për lektorët nga studentet)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD)</i> https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</p> <p><i>Evidenca_Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD, Tabela përmbledhëse e vlerësimit të personelit akademik nga studentët në nivel njësie bazë. Aneksi III.</i> https://uamd.edu.al/wp-</p>

	<p><i>content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.39_ (Formulari i vlerësimit për lektorët nga studentet)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë ka krijuar mundësi për pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve në diskutime të hapura, me qëllim përmirësimin e aspekteve praktike të formimit teorik. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për çështje të ndryshme të interesit të përgjithshëm në institucionet e arsimit të lartë, duke përfshirë planet dhe programet e studimeve, rregulloret e aktiviteteve mësimore, dhe të drejtat e studentëve. Po ashtu, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor përmban një përfaqësues të studentëve që kontribuon me mendimet e tyre për përmirësimin e programeve të studimeve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me ligjin dhe akte nënligjore, zhvillon pyetësorë për matjen e performancës dhe kënaqësisë së studentëve. Ky proces vlerësimi përfshin një vlerësim periodik të metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve.</p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit) Neni 97.</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.9_ (Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të studimeve Master Profesional "Shërbime Sociale dhe Komunitare", Neni 12</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik, të cilat i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, si dhe në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të Stafit Akademik, të vlerësuar. UAMD ka ngritur Sektorin e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës, si dhe Njesinë për Sigurimin e Cilësisë e cila monitoron, shqyrton, mbikëqyr programet e studimit dhe është e përgjegjëse për sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe</p>	<p>UAMD mbështet dhe inkurajon kualifikimin e mëtijshëm të personelit akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca shkencore, si në vend ashtu edhe jashtë tij, dhe ofron mbështetje për</p>

<p>rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>botime në revistat shkencore të UAMD-së dhe të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe për aktivitetet akademike të tjera. Përmes mekanizmave të matshëm të vetëvlerësimit periodik dhe rezultateve të marra nga vëzhgimet dhe pyetësorët, Fakulteti i Edukimit dhe njësitë përkatëse inkurajojnë personelin akademik të përmirësojë kapacitetet dhe performancën e tij në mësimdhënie. Aktivitetet akademike, përfshirë leksionet e hapura, ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies. Çdo departament është pajisur me video projektorë, të cilët përdoren nga lektorët gjatë mësimdhënies. Në sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe proceset e vlerësimit, përveç rregullave të përcaktuara për funksionimin e këtij sistemi, përfshihen edhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm. Vlerësimi i këtyre bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve, që lidhen me programin e studimit, është realizuar gjatë organizimit të takimeve, kryerjes së praktikave profesionale, dhe konferencave në fakultet dhe universitet. Mendimet dhe sugjerimet e tyre janë përdorur për të përmirësuar cilësinë e programeve të studimeve.</p> <p><i>Evidenca_Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD, Për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, Nenet 6, 15.) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf.</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.2_ (Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025, Pika IV). https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies në UAMD sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit dhe vlerësimit të përgjegjës të departamentit dhe dekani. Rezultatet dhe analizat e pyetësorëve i vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik, përgjegjësve të departamenteve, si dhe dekanëve duke diskutuar njëkohësisht edhe problematikat ekzistuese të mundshme dhe planin e masave për përmirësimin e tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se UAMD, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, ka të ngritura dhe funksionale struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Bazuar në rregulloren për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, në nivel institucional strukturat përgjegjëse për sigurimin e standardeve të cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik; - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë; - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë. <p>Në nivel fakulteti, përgjegjës për sigurimin e standardeve të cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve; - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi; - Koordinatorët e programeve. <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC, e cila ka si funksion kryesor bashkëpunimin dhe asistimin e këtij Komisioni. Komisioni mbikëqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm.</p> <p>Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në sistemin e sigurimit</p>

	<p>të brendshëm. Në UAMD, rolin e NjBSC-së e realizon Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.</p> <p>NjBSC në nivel Fakulteti realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC në nivel Institucional. Në realizimin e këtyre objektivave NjBSC në nivel Fakulteti kërkon dosjen e programeve të studimit nga koordinatorët e programeve. Në realizimin e objektivave të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional.</p> <p><i>GVJ mendon se struktura ishte e organizuar me nje personel shumë të limituar në staf dhe sugjeron UAMD të mbajë në konsideratë mundësinë e shtimit të personelit të NjBSC.</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.70_ (Manual për Sistemin e Brendshëm për Sigurimin e Cilësisë në Fakultetin e Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.37_ (Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.95_ (Struktura UAMD 2019)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.1_ (Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu”, Durrës, Neni 24, 77, 80) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga përfaqësues nga secila njësi kryesore e UAMD dhe një përfaqësues të studentëve.</p> <p>Në nivel institucioni funksionon gjithashtu Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e ngritur me Urdhër të Rektorit, e cila përbëhet nga një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një përfaqësues nga studentët. Kjo njësi realizon raporte periodike të vetëvlerësimit në bashkëveprim me</p>

	<p>Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti.GVJ konstaton se Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional NJSBC në nivel Fakulteti si dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë ushtrojnë kompetencat me funksione të plota në ruajtjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë të Institucionit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e programit dhe stafi akademik konfirmojnë së rishikimet e programit të studimit (nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve, përfshirjen e disiplinave të reja, ndryshimi i kategorizimit të disiplinave, apo ndryshime në ECTS dhe ngarkesën e orëve) janë realizuar konform kuadrit ligjor në fuqi me propozime të cilat vijnë nga departamenti dhe me miratim nga senati deri në masën 20 % te programit. Stafi është kryesisht nga fusha e sociologjisë dhe filozofisë, me mungesë të specialistëve në shërbime sociale dhe punë sociale</p> <p><i>Evidenca Nr.6_ (Rregullore UAMD), https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD) https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>UAMD i është nënshtruar në vitin 2016 procesit të akreditimit institucional dhe u vlerësua me një akreditim pozitiv me kohëzgjatje 4 vite akademike.</p> <p>Gjithashtu, sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 18, datë 24.03.2022 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Moisiu”, Durrës”, është vendosur akreditimi periodik institucional, me vlerësim përfundimtar pozitiv, me kohëzgjatjen prej 4 vite akademike dhe afat përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit deri më 23/03/2026.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për</p>	<p>Bazuar në rregulloren për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka në kompetencat e tij kontrollin dhe miratimin e raporteve 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga Njësia e</p>

<p>pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm.</p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur dhe diskutimet me stafin akademik dhe administrativ, konstaton se raportet e deritanishme janë të fokusuara në pasqyrimin e arritjeve dhe të dobësive të programit specifik.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Ruajtja e nivelit të regjistrimeve, nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. Këto të dhëna mblidhen në nivel fakulteti dhe i dërgohen NjBSC-së, çdo fillim viti akademik. Më tej ajo ka për detyrë të japë mendim në formën e sugjerimeve dhe masave korigjuese. Të dhënat, sugjerimet dhe masat korigjuese shqyrtohen nga KPGSC-ja, dhe më pas i propozohen Senatit Akademik për miratim.</p> <p><i>Evidenca_Nr.39_ (Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët)</i> <i>Evidenca_Nr.41_ (Model Pyetësi për Studentët e Diplomuar)</i> <i>Evidenca_Nr.36_ (Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.30_ (RVB e Fakultetit të Edukimit Viti Akademik 2018-2019)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka të ngritura struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore, të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre bazuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit. UAMD ka të hartuara dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Mekanizmat përgjegjës të identifikuar që përdor Institucioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi i studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve dhe të efikasitetit të programeve të studimeve; - raportet e vetëvlerësimit; - vlerësimi i drejtuesit të njësisë kryesore. <p>GVJ konstaton se FE bashkëpunon me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë në përputhje me politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë me qëllim mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit.</p> <p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë, Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore, në varësi të llojit të institucion. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.</p> <p>Departamenti i Sociologjisë dhe Fakulteti i Edukimit përdorin metoda të ndryshme si, kontrollat nga drejtuesit e Fakultetit, analizat dhe diskutimet në mbledhje të departamentit dhe fakultetit, anketimet e studenteve dhe aktorëve të tjerë, matjet e performancës së pedagogëve.</p> <p>Rishikimi i rregullt i programeve dhe përditësimi i elementëve të tyre përbën një pjesë të rëndësishme të procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Ky proces realizohet në përputhje me politikat e cilësisë, procedurat, aktet rregullatore dhe rregulloren e organizimit dhe funksionimit të UAMD. Rezultatet e vlerësimeve pasqyrohen në raportet vjetore të njësive kryesore dhe të institucionit. Procesi i vlerësimit mbështetet në metoda kryesore, ku përfshihen kryesisht pyetësorët, të cilët shërbejnë si mekanizma për matjen dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.38_ (Anketimi i studentëve për Vitin Akademik 2017-2018)</i></p>

	<p><i>Evidenca_Nr.39_ (Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.41_ (Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.36_ (Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Edukimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit, institucioni përdor metoda dhe instrumente të vlerësimit indirekt, siç është pyetësorët e vlerësimit të lëndës. Ky pyetësor zhvillohet çdo fund semestri. Studentët japin vlerësimet e tyre para fillimit të provimeve finale</p> <p>Por raportet analitike dhe vleresuese që përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive në raport me objektivat, parashikimet për periudhat e ardhshme, si edhe adresimin e mangësive duhen përmisuar dhe këtë rishikim periodik të programit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.30_ (Raporte te Fakultetit të Edukimit, Viti Akademik 2019-2021)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.36_ (Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.35_ (Analiza vjetore e Departamentit të Sociologjisë)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i</p>	<p>UAMD përdor matës të tillë si: cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje (nota mesatare), kalueshmëria e kurseve, përqindja e studentëve të diplomuar brenda kohëzgjatjes normale të programit, përqindja e punësimit të studentëve brenda profilit pas diplomimit.</p>

<p>cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimit me pedagogët, Drejtuesen e DS, si edhe studentët se në kuadër të përmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe manualit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Edukimit. Këto metoda të drejtpërdrejta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, ku bën pjesë dhe ky program i studimit; - vlerësimin e didaktikës, kurrikulës, leksioneve, syllabuseve, literaturat e përdorura; - të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve; - procesi i tutoriatit/mentorimit <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimet në IAL konstatoi që departamenti përdor instrumenta të tërthortë vlerësimi, duke mundësuar kështu një vlerësim të plotë të realizimit të objektivave të programit dhe duke mos mundësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD)</i> https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</p> <p><i>Evidenca_Nr.38_ (Anketimi i studentëve për Vitin Akademik 2017-2018)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.39_ (Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.41_ (Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që</p>	<p>Në përmirësimin e cilësisë luan rol të rëndësishëm edhe përfshirja e studentëve dhe palëve të treta. Instrumentat e përdorura për metodën e tërthortë (sondazhe, intervista) janë pasqyruar në nenet e rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Zyra e Keshillimit, Alumnit dhe Karrierës, mbështetur nga njësitë kryesore në IAL, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> organizon pyetësorë drejtuar studentëve dhe ALUMNI për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit;

<p>bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>organizon pyetësorë në formë elektronike drejtuar kompanive/palëve të treta për të analizuar performancën dhe përgatitjen e njohurive që kanë studentët e diplomuar;</p> <p>organizon workshop-ve/panaie pune ku mbledh sugjerimet dhe kërkesat e bizneseve në lidhje me programet e studimeve .</p> <p><i>Evidenca_Nr.39_ (Model Formular Alumni, UAMD)</i> <i>Evidenca_Nr.36_1 (Raporti i rezultateve të anketimit të studentëve, stafit akademik dhe administratës mbi institucionin, 2019.</i> <i>Evidenca_Nr.112_ (Takime Alumni dhe akademike; Të dhëna dhe info për Alumni, UAMD).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. GVJ evidenton nevojën për të adresuar në përputhje me kapacitetet ekzistuese që programi tashmë zotëron, palët e treta, si dhe analizën e përditësuar e sistematike të ecurisë së punës në programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar</p>	<p>Në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) operon Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit, i cili përbëhet nga 7 anëtarë, ku njëri prej tyre është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e komisionit, të cilët janë përfaqësues nga radhët e UAMD-së, vetëkandidohen dhe më pas zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.</p> <p>Duke iu referuar përbërjes së Senatit Akademik – organit më të lartë kolegjal akademik të UAMD-së – si dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë</p>

<p>të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, është e qartë që institucioni siguron dhe promovon përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar. Kjo përfshirje synon garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përmes zbatimit të politikave dhe procedurave të përcaktuara.</p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.1_ (Statuti UAMD), https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në strukturat e ngritura për Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UAMD nëpërmjet Rregulloreve të posaçme për këtë qëllim ka përcaktuar përgjegjësitë e detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, nëpërmjet ngritjes së grupit të punës së vlerësimit të brendshëm.</p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.1_ (Statuti UAMD), https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>DS është përgjegjës për mirëfunktionimin e programeve të studimit që mbulon, si dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit në bashkëpunim me të gjitha nivelet e strukturave përbërëse të UAMD, kjo bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore që institucioni ka të parashikuar.</p> <p>GVJ konstaton se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, pedagogët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti.</p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.1_ (Statuti UAMD), https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin</p>	<p>Rregullorja e UAMD, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë garantojnë integritetin akademik dhe shmangien e diskriminimit apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve. Ato garantojnë një pjesëmarrje të drejtë të personelit akademik, ndihmës akademik e të studentëve në këtë proces.</p>

<p>akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UAMD.</p> <p>Zbatimi i detyrave të lëna nga grupe të jashtme vlerësimi, auditimi dhe hartimi i planit të masave janë disa nga elementët kyç që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, kontrollin e vazhdueshëm të saj gjatë zhvillimit të programit të studimit, që aplikojnë njësitë përgjegjëse sipas fushës së veprimtarisë në FE-UAMD.</p> <p>Përzgjedhja e personelit për këtë proces bazohet në kontributin, seriozitetin dhe integritetin akademik. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve</p> <p><i>Evidenca_Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD)</i> https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</p> <p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore UAMD)</i>, https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Edukimit)</i></p> <p><i>Evidenca_Nr.16_ (Kodi i Etikës në UAMD)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Institucioni dëshmon angazhimin edhe të aktorëve të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit.</p> <p>GVJ konstaton se po përfshihen në procesin e vlerësimit, sigurimit të brendshëm të cilësisë, e përmirësimin e saj, edhe përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë vazhdimisht bashkëpunëtorë, partnerë ose dhe studentë të diplomuar, të cilët ndihen pjesë integrale e çdo procesi me rëndësi në fakultet, apo në veprimtarinë e cilësisë së programit të studimit. Në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe proceset e vlerësimit, bazuar në rregullat e përcaktuara të funksionimit të këtij sistemi përfshihen ekspertë të jashtëm, të cilët kanë dhënë mendime dhe ekspertizën e tyre në lidhje me cilësinë dhe dhe përmirësimet e mundshme të tij.</p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Eukimit)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga takimet e drejtpërdrejta me studentët, GVJ konstatoi se për studentët realizohet java informuese, ku ata informohen nga lektorët e departamentit në lidhje me funksionimin dhe organizimin e çdo programi studimi.</p> <p>Pranë UAMD prej vitesh realizohet raportimi vjetor nga ana e rektoratit lidhur me realizimin e objektivave të parashtruara. Në të njëjtin format edhe pranë fakulteteve dhe departamenteve realizohet në mënyrë periodike informim dhe mendimarrje nga strukturat e ndryshme me kolegët lektorë, stafin administrativ dhe studentët.</p> <p>Nëpërmjet web-it të UAMD, komunikimeve më email, takimeve informuese dhe publikimeve në rrjetet sociale studentët informohen periodikisht për organizimin, strategjitë, politikat, veprimtaritë dhe masat e marra për ecurinë dhe përmirësimin e cilësisë. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Evidenca_Nr.10_ (Rregullore e NJSBC UAMD)</i> https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf</p> <p><i>Evidenca_Nr.6_ (Rregullore UAMD),</i> https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</p> <p><i>Evidenca_Nr.7_ (Rregullore e Fakultetit të Eukimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit iu vihen në dispozicion personelit akademik, dhe publikohen për studentët dhe aktorët e tjerë.</p> <p>GVJ konstaton se është përgatitur programi i transparencës i cili konsiston në përcaktimin e rregullave bazë të organizimit dhe të funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Programi i transparencës në UAMD i shërben rritjes së transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale të universitetit sipas objektit dhe qëllimit të këtij ligji duke pasur parasysh interesin më të mirë të publikut. Publikimi i informacionit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>përmes këtij programi ka si qëllim t'i shërbejë transparencës të organizimit dhe funksionimit si dhe të misionit dhe veprimtarisë së UAMD-së dhe realizohet përmes publikimit të detajuar të këtij informacioni në faqen zyrtare të www.uamd.edu.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut.</p> <p><i>Evidenca_Nr.36_ (Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.13_1 (Raport dhe pyetësori për studentët për matjen e nivelit të kënaqësisë me shërbimet e sektorit të Karrierës dhe Alumnit në UAMD, Gusht -Shtator 2021).</i> <i>Evidenca_Nr.40_ (Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut)</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë/strukturat përkatëse, hartojnë plane të masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna.</p> <p>Nga takimi që pati GVJ vuri re se Departamenti i Sociologjisë dhe Fakulteti i Edukimit angazhohen që kanë marrë dhe do të marrin masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme.</p> <p><i>Evidenca_Nr.36_ (Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.13_1 (Raport dhe pyetësori për studentët për matjen e nivelit të kënaqësisë me shërbimet e sektorit të Karrierës dhe Alumnit në UAMD, Gusht -Shtator 2021).</i> <i>Evidenca_Nr.40_ (Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashëpunimit me Departamentin, Fakultetin dhe Njësitë ndihmëse akademike. Produkt i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL që dorëzohet në MASR. Raportet diskutohen në strukturat vendimarrëse përpara se të publikohen dhe miratohen prej tyre. Në mënyrë periodike, edhe nga analizat, departamenti dhe fakulteti vlerësojnë ecurinë e politikave dhe strategjive të ndjekura deri më tani.</p> <p><i>Evidenca_Nr.19_ (Analize Vjetore në Departament per Programin e Studimit Master Profesional, SHSK)</i> <i>Evidenca_Nr.35_ (Analiza vjetore e Departamentit të Sociologjisë)</i></p>

	<p><i>Evidenca_Nr.36_ (Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Edukimit)</i> <i>Evidenca_Nr.41_ (Model Pyetësi për Studentët e Diplomuar)</i> <i>Evidenca_Nr.39_ (Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti dhe departamenti organizojnë takime informuese për ndryshimet e ndodhura dhe përmirësimet e mëtejshme. Njëkohësisht, personeli është në dispozicion në ditë dhe në orare të ndryshme për studentët. Nga takimet me stafin akademik, GVJ konstaton se NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe të fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e të vlerësimit të cilësisë. Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë: informimi i stafit për proceset e vlerësimit; informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit; përfshirja e studentëve në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e performancës.</p> <p><i>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 10_Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë).Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Sociologjise organizojnë takime informuese për ndryshimet e ndodhura dhe përmirësimet e mëtejshme në mënyrë periodike. Njëkohësisht, personeli është në dispozicion në ditë dhe në orare të ndryshme për studentët. ³ Evidenca_Nr.30_ (Raportet e brendshme ne Fakultetit të Edukimit Viti Akademik 2020-2021)</i> <i>Evidenca_Nr.19_ (Analizë Vjetore për Programin e Studimit Master Profesional SHSK)</i> <i>Evidenca_Nr.5_ (Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit - MP SHSK)</i> <i>Evidenca_Nr.111_ (Sondazhi Kombëtar i Studentëve _ Takimet informuese dhe udhëzuese , 2019)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive dhe synojnë krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³ Evidenca_Nr.76_ (Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Edukimit)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master


Profesional “Shërbime Sociale dhe Komunitare”, “Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës”

a) Pikat e forta dhe afirmime

1. Program “Master Profesional Shërbime Sociale dhe Komunitare” është ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e Institucionit, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës.
2. Program në përputhje me kuadrin ligjor: Programi është i strukturuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
3. Kapacitetet dhe Burimet e Institucionit: UAMD ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programit, si dhe struktura që ofrojnë trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar.
4. Pjesëmarrja e Studentëve dhe Monitorimi i Cilësisë: Studentët janë të angazhuar në vendimmarrje dhe proceset e përmirësimit të cilësisë, ndërsa UAMD ndjek politika të qarta për sigurimin dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, duke përdorur pyetësorë dhe analiza për përmirësimin e procesit mësimor.

b) Pikat e dobëta

1. Staf i Akademik jo i specializuar në fushën e shërbimeve sociale: Staf i është kryesisht nga fusha e sociologjisë dhe filozofisë, me mungesë të specialistëve në shërbime sociale dhe punë sociale. *(Standardi II.2, Kriteri 1)*
2. Praktikë profesionale e pamjaftueshme: Duhet të rritet numri i orëve të praktikës profesionale jo vetëm në lëndën e praktikës por edhe në lëndët e tjera mund të shihet mundësia për shtimin e orëve praktike; duhet të rritet numri i organizatave bashkëpunuese në fuqion të praktikës profesionale. *(Standardi V.3, Kriteri 3)*
3. Proceset e konsultimit dhe rishikimit periodik të programit të studimit: Proceset e konsultimeve me të diplomuarit dhe aktorët e tregut të punës janë të pamjaftueshme dhe nuk janë të strukturuar në mënyrë sistematike. Nevojitet formalizimi dhe intensifikimi i këtyre proceseve për një bashkëpunim dhe kontribut më domethënës dhe të dokumentuar të angazhimit të grupeve të interesit. *(Standardi IV., Kriteri 7)*
4. Pajisjet dhe literaturë: Mjediset mësimore kërkojnë pajisje më moderne dhe përditësim të literaturës në bibliotekë për të përputhur me zhvillimet e fundit në fushë. *(Standardi IV.2, Kriteri 1)*
5. Mungesa e një sistemi për të identifikuar dhe trajtuar çështjet e plagjiazmit: Duhet zhvilluar një sistem i përbashkët për identifikimin e plagjaturave në detyrat e kursit dhe temat e diplomave dhe më pas një sistem rregullator për trajtimin e këtyre rasteve. *(Standardi III.3, Kriteri 5)*



Rekomandime

1. Departamenti duhet të konsiderojë mundësinë për riorganizimin e plotë të programit në fushën e shërbimeve sociale për ta përshtatur edhe me nevojat më specifike të tregut të punës.
2. Rekomandohet organizimi i proceseve periodike e të qëndrueshme të përditësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, në konsultim të ngushtë me organizatat dhe institucionet partnere në funksion të programit të studimit, për të ofruar një program në përputhje të plotë me nevojat e tregut të punës.
3. Të rikonceptohet praktika profesionale duke shtuar orët e praktikës në institucion dhe duke konsideruar shtimin e orëve të praktikës edhe në lëndët e tipologjisë B. Institucioni duhet të zgjerojë rrjetin e institucioneve bashkëpunuese në funksion të praktikës profesionale dhe të ruajë komunikim dhe konsultim të vazhdueshëm me qëllim përgatitjen e duhur profesionale dhe teorike të studentëve. Gjithashtu të korrigohet gabimi në llogaritjen e numrit total të orëve për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse.
4. Departamenti duhet të angazhojë pedagogë të kualifikuar në fushën e punës sociale si dhe të konsolidojë proceset e kualifikimit të vazhdueshëm profesional të stafit akademik lidhur me metodologjitë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe integrimin e teknologjisë në mësimdhënie
5. Rekomandohet pasurim dhe përditësim i vazhdueshëm i literaturës për të rritur përputhshmërinë me zhvillimet më të fundit në fushën bashkëkohore dhe lokale, si dhe pajisja e pasurimi i mëtejshëm i mjediseve edhe me mjete të tjera më të fundit teknologjike dhe pajisja e çdo auditori me video-projektor.
6. Të përmirësohen e bëhen më të arritshme, prezentë e funksionale për studentët procedurat për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve dhe menaxhimin e ankimimeve e problematikave.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Social and community services" provided by "Aleksandër Moisiu", University.

Strengths and affirmations

1. The program "Professional Master's in Social and Community Services" is built in accordance with the institution's vision and mission, higher education reform objectives in the country, and the Bologna Process.
2. Compliance with Legal Framework: The program is structured in line with domestic legislation and the European Credit Transfer and Accumulation System (ECTS).
3. Institution's Capacities and Resources: UAMD has the necessary experience, capacities, and resources to offer the program, including structures that provide further professional training for graduates.



4. **Student Participation and Quality Monitoring:** Students are involved in decision-making and quality improvement processes. UAMD follows clear policies for ensuring and monitoring teaching quality, utilizing questionnaires and analyses to improve the educational process.

Weaknesses

1. **Non-specialized Academic Staff in Social Services:** The academic staff primarily comes from the fields of sociology and philosophy, with a notable lack of specialists in social services and social work. **(Standard II.2, Criterion 1)**
2. **Insufficient Professional Practice Opportunities:** The number of hours dedicated to professional practice needs to be increased, not only in the practical course but also by incorporating practical hours into other subjects. Additionally, the number of partner organizations for professional practice should be expanded. **(Standard V.3, Criterion 3)**
3. **Consultation and Periodic Review Processes for the Study Program:** The consultation processes with graduates and labor market stakeholders are insufficient and lack systematic structure. Formalizing and intensifying these processes is essential to ensure meaningful and well-documented collaboration and engagement with stakeholders. **(Standard IV.1, Criterion 7)**
4. **Equipment and Literature:** Learning facilities require more modern equipment, and the library needs updated literature to align with the latest developments in the field. **(Standard IV.2, Criterion 1)**
5. **Lack of a System to Identify and Address Plagiarism Issues:** A unified system for identifying plagiarism in coursework and theses must be developed, along with a regulatory framework for addressing such cases. **(Standard III.3, Criterion 5)**

Recommendations

1. The department should consider the possibility of a complete reorganization of the program in the field of social services to better adapt to the more specific needs of the job market.
2. It is recommended to organize periodic and sustainable processes for the continuous updating and improvement of the program content, in close consultation with partner organizations and institutions in function of the study program, to offer a program in full compliance with the needs of the job market.
3. The professional practice should be re-conceptualized by increasing the hours of practice within the program, and considering adding practice hours in Type B courses as well. The institution should expand its network of collaborating institutions for professional practice and maintain continuous communication and consultation to ensure the proper professional and theoretical preparation of students. Additionally, the error in calculating the total number of hours for professional practice and final obligations should be corrected.

4. The department should engage qualified lecturers in the field of social work and consolidate the processes of continuous professional qualification of the academic staff related to teaching methodologies, scientific research, and the integration of technology in teaching.
5. It is recommended to continuously enrich and update the literature to increase alignment with the latest developments in contemporary and local fields, as well as to further equip and enrich the environments with the latest technological tools, including equipping each classroom with a video projector.
6. The procedures for receiving, orienting, advising students, and managing appeals and issues should be improved and made more accessible, present, and functional for students.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

